



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 02/1218 dt. 28 / 03 /2025

Në bazë të nenit 24 parag.1 të Statutit të Universitetit Publik " Kadri Zeka" në Gjilan, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e katërt (IV) të mbajtur me 27.03.2025, mori:

VENDIM

- I. **Miratohet** raporti vjetor i punës i Universitetit Publik" Kadri Zeka" në Gjilan, për vitin 2024.
- II. Vendimit i bashkangjitet raporti vjetor i punës për vitin 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi raportin e detajuar të punës për vitin 2024 në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, konstatoi se raporti është i strukturuar mire dhe i përmban të gjitha të dhënat e parapara në nenin 24, parag.1 i statutit të UKZ.

Përmes raportit vjetor pasqyrohet veprimtaria e Universitetit konform obligimeve ligjore duke u mbështetur në punën efektive gjatë vitit 2024.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryesuesi i KD-së

Dr. Techn. Ilir Gjinolli

Vendimi t'i dërgohet:

- Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- Menaxhmetit të UKZ-së,
- Arkivit të UKZ-se.



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” PUBLIC UNIVERSITY
G J I L A N

RAPORT VJETOR I PUNËS

2024

Gjilan, mars 2025

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	i
Lista e tabelave	ii
Fjala hyrëse e rektorit	1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
HYRJE	6
METODOLOGJIA E HARTIMIT	8
1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË ARRITURA.....	9
2. PUNA E ORGANEVE QEVERISËSE	20
2.1. Të dhëna për Këshillin Drejtues	20
2.2. Të dhëna për Senatin	21
3. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME STATISTIKORE	23
3.1. Buxheti (fondet publike dhe private)	23
3.1.1. Raporti i prokurimit 33	
3.2. Personeli (shifrat zhvillimore)	38
3.3. Infrastruktura	47
3.4. Profili akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.).....	53
3.5. Programet e studimit.....	53
3.6. Numri i studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit)	56
3.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet).....	72
3.8. Bashkëpunimi ndërkombëtar	79
PËRFUNDIME	84
SHTOJCAT	87

Lista e tabelave

<i>Tabela 1. Buxheti dhe shpenzimet janar –dhjetor 2024</i>	<i>24</i>
<i>Tabela 2. Fondet burimore</i>	<i>24</i>
<i>Tabela 3. Të hyrat vetanake.....</i>	<i>25</i>
<i>Tabela 4. Shpenzimet dhe buxheti i projekteve (fondi burimor 49).....</i>	<i>26</i>
<i>Tabela 5. Paga dhe shtesa</i>	<i>27</i>
<i>Tabela 6. Mallra dhe shërbime.....</i>	<i>28</i>
<i>Tabela 7. Shpenzimet komunale.....</i>	<i>31</i>
<i>Tabela 8. Subvencione dhe transfere</i>	<i>31</i>
<i>Tabela 9. Shpenzimet kapitale</i>	<i>32</i>
<i>Tabela 10. Buxheti dhe shpenzimet e projekteve ndërkombëtare (fondi burimor 49).....</i>	<i>33</i>
<i>Tabela 11. Numri, lloji dhe çmimi i procedurës</i>	<i>34</i>
<i>Tabela 12. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës së mesme dhe vlera monetare</i>	<i>36</i>
<i>Tabela 13. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës së vogël dhe vlera monetare</i>	<i>37</i>
<i>Tabela 14. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës minimale dhe vlera monetare</i>	<i>37</i>
<i>Tabela 15. Personeli akademik.....</i>	<i>41</i>
<i>Tabela 16. Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë.....</i>	<i>46</i>
<i>Tabela 17. Stafi akademik dhe administrativ.....</i>	<i>46</i>
<i>Tabela 18. Zyrat e KD, menaxhmentit, dekanëve, stafit akademik, stafit administrativ, parlamentit studentor dhe depos.....</i>	<i>49</i>
<i>Tabela 19. Sallat e mësimit, kabinetet e informatikës dhe laboratorët</i>	<i>49</i>
<i>Tabela 20. Pajisjet</i>	<i>50</i>
<i>Tabela 21. Pajisjet</i>	<i>51</i>
<i>Tabela 22. Numri i kompjuterëve (desktopë dhe laptopë) funksionale që disponon Universiteti</i>	<i>52</i>
<i>Tabela 23. Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme</i>	<i>52</i>
<i>Tabela 24. Programet e studimit</i>	<i>54</i>
<i>Tabela 25. Riakreditim të programeve studimore</i>	<i>55</i>
<i>Tabela 26. Akreditimi institucional.....</i>	<i>56</i>
<i>Tabela 27. Te dhënat e përgjithshme për studentet e pranuar, aktual, të transferuar, të diplomuar dhe të çregjistruar</i>	<i>58</i>
<i>Tabela 28. Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2024/2025. Niveli Bachelor</i>	<i>59</i>
<i>Tabela 29. Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2024/2025 Niveli Master</i>	<i>60</i>
<i>Tabela 30. Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor</i>	<i>61</i>
<i>Tabela 31 Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike - niveli master</i>	<i>63</i>
<i>Tabela 32. Numri i studentëve të transferuar - niveli baçelor.....</i>	<i>64</i>
<i>Tabela 33. Numri i studentëve të transferuar - niveli master</i>	<i>65</i>
<i>Tabela 34. Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor</i>	<i>66</i>
<i>Tabela 35. Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike, niveli master</i>	<i>67</i>
<i>Tabela 36. Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2024/2025 - niveli baçelor.....</i>	<i>68</i>
<i>Tabela 37. Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2024/2025 - niveli master</i>	<i>69</i>
<i>Tabela 38. Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor ...</i>	<i>70</i>
<i>Tabela 39. Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike - niveli master</i>	<i>71</i>

<i>Tabela 40. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakultetit të Edukimit, gjatë vitit 2024.</i>	<i>73</i>
<i>Tabela 41. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti Juridik, gjatë vitit 2024.....</i>	<i>75</i>
<i>Tabela 42. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti Ekonomik, gjatë vitit 2024.....</i>	<i>76</i>
<i>Tabela 43. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, gjatë vitit 2024.....</i>	<i>77</i>
<i>Tabela 44. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti i Shkencave Aplikative, gjatë vitit 2024.</i>	<i>77</i>
<i>Tabela 45. Rezultatet kryesore të arritura në 2024</i>	<i>81</i>

Fjala hyrëse e rektorit

Të nderuar anëtarë të personelit akademik, partnerë institucionalë, studentë dhe miq të Universitetit Publik “Kadri Zeka”,

Në cilësinë e rektorit të këtij institucioni, kam nderin t’ju prezantoj *Raportin Vjetor të Punës për vitin 2024*, një dokument ky që pasqyron përkushtimin, arritjet dhe vizionin e përbashkët të komunitetit tonë universitar në ndërtimin e një institucioni arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe me ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e shoqërisë sonë.

Ky raport përbën një reflektim mbi të arriturat, sfidat dhe rrugëtimin e Universitetit gjatë një viti, i cili shënoi zhvillim të rëndësishëm akademik, shkencor dhe organizativ për UKZ-në. Viti 2024 u karakterizua nga angazhime të shumta dhe zhvillime domethënëse në të gjitha nivelet. Universiteti shënoi progres të qëndrueshëm në fushën e *akreditimit, të ndërkombëtarizimit, të kërkimit shkencor dhe të përmirësimit të infrastrukturës*, duke dëshmuar një orientim të qartë drejt cilësisë dhe modernizimit.

Ndër arritjet më të rëndësishme *veçojmë riakreditimin institucional për një periudhë pesëvjeçare*, si një dëshmi të përmbushjes së standardeve akademike dhe menaxheriale. Gjatë këtij viti, janë akredituar dhe riakredituar *tetë (8) programe studimore*, përfshirë *pesë programe të riakredituara dhe tri (3) programe të reja*, të dizajnuara në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet bashkëkohore në arsim.

Në fushën e *kërkimit shkencor*, UKZ ka shënuar rritje të ndjeshme të aktivitetit akademik. Janë mbështetur botimet e mësimdhënësve të rregullt të UKZ-së në revista të indeksuara ndërkombëtarisht, është ndarë për herë të dytë *Çmimi “Hulumtuesi i vitit”*, si dhe është organizuar me sukses *Konferenca Vjetore Shkencore 2024*, me mbi 120 pjesëmarrës nga brenda dhe jashtë vendit, një ndër momentet kulmore të kalendarit akademik.

Në aspektin e *infrastrukturës*, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt zhvillimit të *kampusit të ri universitar*, në bashkëpunim me MASHTI-n dhe autoritetet lokale. Po ashtu, janë realizuar investime në *rinovimin e objekteve ekzistuese*, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe mësimdhënies për stafin dhe studentët tanë.

Me rëndësi të veçantë është edhe *rregullimi i dokumentacionit të pronësisë së objektit ekzistues të universitetit*, në bashkëpunim me *komunën e Gjilanit*, duke mundësuar *zgjerimin e hapësirave aktuale të institucionit*. Po ashtu, universiteti është në pritje të *nënshkrimit të marrëveshjeve të reja për zgjerim të mëtejshëm të kampusit*, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të infrastrukturës arsimore.

Përveç kësaj, janë ndërmarrë masa konkrete drejt *përmirësimit të menaxhimit të brendshëm institucional*, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve njerëzore, rishikimin e rregulloreve, si dhe avancimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë – veprime këto që synojnë rritjen e efikasitetit dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm akademik.

Përmes marrëveshjeve të reja ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes aktive në projekte të financuara nga BE dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, universiteti ka forcuar profilin e tij si një institucion me dimension ndërkombëtar dhe përfshirje të gjerë akademike.

Natyrisht, sfidat nuk kanë munguar – nga kufizimet buxhetore te nevoja për reforma të brendshme dhe përballja me procedura institucionale komplekse. Megjithatë, përmes përkushtimit të përbashkët, dialogut të hapur dhe një qasjeje konstruktive, kemi arritur t'i përballojmë me profesionalizëm dhe vendosmëri.

Duke parë drejt së ardhmes, Universiteti Publik “Kadri Zeka” do të vazhdojë të konsolidojë rolin e tij si një institucion lider në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Kosovë. Prioritetet tona për vitin 2025 përfshijnë: thellimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare; zhvillimin e programeve inovative; integrimin e teknologjive moderne në procesin mësimor dhe përshtatjen e vazhdueshme me nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë.

Në përmbyllje, dëshiroj të shpreh mirënjohjen më të thellë për të gjithë stafin akademik dhe administrativ, për studentët tanë, burimi ynë i përhershëm i frymëzimit, si dhe për të gjithë partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e palëkundur dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. Arritjet e këtij viti janë rezultat i punës së përbashkët dhe i besimit të ndërsjellë në misionin tonë edukativ dhe shkencor.

Me bindje të plotë e them se viti 2025 do të jetë një mundësi për thellimin e reformave, rritjen e cilësisë dhe konsolidimin e UKZ-së, si një qendër e dijes, inovacionit dhe zhvillimit shoqëror, gjithmonë në funksion të një të ardhme më të ndritur për arsimin e lartë në Kosovë.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Artan DËRMAKU

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport vjetor paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse të zhvillimeve, arritjeve dhe sfidave të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan për vitin kalendarik 2024. Qëllimi kryesor i raportit është të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe transparente të progresit institucional në përmbushjen e objektivave strategjike, si dhe të shërbejë si instrument orientues për vendimmarrje dhe planifikim të mëtejshëm.

Në vitin 2024, UKZ ka përmbushur një sërë objektivash kyçe në fushat akademike, shkencore, menaxheriale dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke ndërtuar një bazë të qëndrueshme për zhvillim të mëtejshëm.

Rezultatet kyçe për vitin 2024 përfshijnë

- *Riakreditimin institucional për një periudhë pesëvjeçare (5) një arritje e rëndësishme që dëshmon përmbushjen e standardeve akademike dhe administrative të cilësisë;*
- *Akreditimin dhe riakreditimin e gjithsej tetë (8) programeve studimore të nivelit të studimeve баçelor dhe master, në të gjitha njësitë akademike, përfshirë hartimin e programeve të reja që adresojnë nevojat e tregut dhe zhvillimet bashkëkohore të arsimit të lartë. Përmirësimi i vlerësimit të lëndëve/kurseve, monitorimi i performancës dhe raportimi i të dhënave statistikore mbi diplomimin, çregjistrimin dhe progresin akademik;*
- *Zhvillimin e kërkimeve shkencore, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të 26 punimeve shkencore, publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht (SCOPUS dhe WoS), pjesëmarrjes në konferenca dhe ndarjes së çmimeve për kontributet shkencore;*
- *Organizimin e Konferencës vjetore shkencore me 124 pjesëmarrës nga brenda dhe jashtë vendit, e cila shërbeu si një platformë akademike për ndarjen e dijes dhe zhvillimin e rrjeteve profesionale; shpallja për herë të dytë i çmimeve “Hulumtuesi i vitit” dhe “Marin Balleti”; themelimi i qendrave dhe grupeve kërkimore, brenda njësive akademike;*
- *Zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si: nënshkrimi i 18 marrëveshje të reja bashkëpunimi me universitete dhe institucione evropiane, rajonale dhe vendore, që mbulojnë fusha të tilla si mobiliteti akademik, kërkimi shkencor, digjitalizimi, klinikat ligjore dhe zhvillimi institucional; pjesëmarrje aktive në mbi 15 projekte ndërkombëtare, përfshirë projekte të financuara nga programet Erasmus+, HERAS+, IPA, UNHCR, Banka Botërore dhe qeveria zvicerane; zhvillimi i 6 projekteve të reja të nisura në vitin 2024, përfshirë REISSE UP, EMPHASIS, EDUFAIR, STEM Europe, DELTA dhe TIKA-Cezeri Lab; realizimi mobiliteteve për 25 studentë dhe 50 staf akademik dhe administrativ në kuadër të programit Erasmus+;*
- *Miratimin e Strategjisë për zgjerimin dhe rikonstruktimin e hapësirave ekzistuese 2025–2027;*

- *Fillimin e procedurave konkrete për ndërtimin e kampusit të ri universitar*, si një ndër prioritetet infrastrukture të institucionit (përfshirë në projektet WBIF dhe të miratuar nga Qeveria);
- *Investimet kapitale* në objektin ekzistues: në renovimin e Rektoratit, furnizimin me pajisje IT, softuer antiplagjiat, printerë dhe sistem të vijueshmërisë;
- *Zhvillimin e praktikave menaxheriale dhe qeverisëse*, përmes rishikimit të rregulloreve, përmirësimit të sistemeve të brendshme, forcimit të transparencës dhe vlerësimit të performancës institucionale;
- *Organizimin e trajnimeve* për stafin në bashkëpunim me IKAP, HERAS dhe institucione partnere ndërkombëtare;
- *Miratimin e planeve vjetore të zhvillimit profesional* dhe janë identifikuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve.

Sfidat e hasura gjatë vitit 2024

- *Kufizimet buxhetore*, të cilat ndikuan në zbatimin e disa projekteve të planifikuara;
- *Procedurat e ndërlikuara administrative dhe burokratike*, sidomos në aspektin e investimeve publike dhe zhvillimit të infrastrukturës;
- *Nevoja për rritje të kapaciteteve profesionale dhe teknike*, si në fushën akademike ashtu edhe atë administrative;
- *Menaxhimi i resurseve njerëzore dhe përmbushja e nevojave të reja për staf*, për shkak të rritjes së aktiviteteve institucionale dhe ndërkombëtare.

Objektivat për vitin 2025

Në vitin 2025, UKZ do të fokusohet në:

- Finalizimin e procedurave për ndërtimin e *kampusit të ri universitar*, në bashkëpunim me MASHTI-n dhe komunën e Gjilanit;
- Zhvillimin e *programeve të reja studimore*, të orientuara drejt tregut të punës, teknologjisë dhe nevojave të komunitetit;
- Forcimin e *kërkimit shkencor dhe inovacionit*, përmes projekteve ndërkombëtare, klinikave ligjore dhe qendrave kërkimore ndërdisiplinare;
- Thellimin e *bashkëpunimeve ndërkombëtare* dhe rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit;
- Përmirësimin e *shërbimeve për studentë dhe staf*, përmes digjitalizimit të proceseve, sistemit SMU dhe trajnimeve të vazhdueshme;

- Konsolidimin e *qeverisjes universitare*, me theks në transparencë, efikasitet dhe llogaridhënie.

Përfundimisht mund të thuhet se viti 2024 ishte një vit i përparimeve të prekshme dhe i konsolidimit të mëtejshëm të rolit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Rezultatet e arritura janë dëshmi e një përkushtimi të përbashkët për arsim cilësor, zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim ndërkombëtar. Në vitet që vijnë, UKZ do të vazhdojë të jetë një institucion aktiv, inovativ dhe në shërbim të shoqërisë.

HYRJE

Raporti vjetor i punës për vitin 2024 i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan është përgatitur në mbështetje të *nenit 24, pika 1, të Statutit të Universitetit Publik “Kadri Zeka”*, i cili përcakton obligimin institucional për raportim të rregullt dhe transparent të të gjitha aktiviteteve akademike, kërkimore, administrative dhe zhvillimore të universitetit. Ky raport përmbledh veprimtarinë e Universitetit përgjatë periudhës *janar – dhjetor 2024*, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe të dokumentuar të ecurisë institucionale përpara organeve drejtuese, komunitetit universitar dhe palëve të interesit.

Ky dokument shërben si instrument reflektues për komunitetin universitar, partnerët institucionalë dhe publikun e gjerë, duke ofruar një bazë për vlerësim objektiv të performancës institucionale dhe për planifikimin e prioriteteve për periudhën e ardhshme. Ai përmbledh të dhënat kryesore të aktivitetit të Universitetit, analizon progresin drejt objektivave strategjike dhe përshkruan kontekstin operacional në të cilin UKZ ka vepruar gjatë vitit 2024.

Universiteti Publik “Kadri Zeka”, gjatë këtij viti ka përmbushur detyra të rëndësishme në funksion të ofrimit të arsimit cilësor, zhvillimit të kërkimeve shkencore, zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe përmirësimit të kushteve të infrastrukturës fizike dhe digjitale. Aktivitetet janë zhvilluar në një kontekst sfidues, me presione financiare, rregullative dhe menaxheriale, por falë përkushtimit të stafit dhe mbështetjes së partnerëve institucionalë, universiteti ka arritur të ruajë stabilitetin dhe të avancojë në disa fusha kyçe.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një *vlerësim të gjithanshëm të progresit të arritur*, të sfidave të përballuara dhe të orientimeve strategjike të universitetit, në përputhje me *Planin Strategjik 2023–2028* dhe dokumentet tjera përkatëse. Raporti është konceptuar si një mjet për *rritjen e transparencës, përmirësimin e qeverisjes dhe orientimin e vendimmarrjes së ardhshme*, duke shërbyer njëkohësisht si bazë për monitorim, reflektim dhe planifikim të mëtejshëm institucional.

Struktura e raportit është ndarë sipas fushave strategjike të veprimit dhe ofron një përmbajtje të balancuar ndërmjet të dhënave numerike, përshkrimeve cilësore dhe analizave të rezultateve. Raporti përbëhet nga këto pjesë kryesore:

1. **Fjala hyrëse e rektorit**, me fokus në zhvillimet strategjike dhe institucionale;
2. **Përmbledhja ekzekutive** – me theks në qëllimin, rezultatet kyçe, sfidat dhe objektivat për të ardhmen;
3. Pjesa e parë: **Objektivat strategjike** – raportim mbi zbatimin e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike të universitetit, të ndarë në pesë fusha:
 - Ofrimi i programeve cilësore dhe zhvillimi akademik,
 - Aktivitetet shkencore dhe kërkimore,
 - Ndërkombëtarizimi dhe projektet,
 - Infrastruktura dhe digjitalizimi,
 - Praktikat menaxheriale dhe qeverisja e brendshme.

4. Pjesa e dytë: ***Funksionimi institucional*** – përfshin të dhëna për punën e organeve qeverisëse (Këshilli Drejtues dhe Senati), personelin akademik dhe administrativ, numrin e studentëve dhe indikatorë tjerë operacionalë.
5. Pjesa e tretë: ***Të dhënat e përgjithshme statistikore***
 - *Buxheti dhe menaxhimi i burimeve* – paraqet analizën e buxhetit të realizuar, kategoritë e shpenzimeve, burimet e financimit dhe sfidat buxhetore;
 - *Personeli dhe shifrat zhvillimore* ku paraqiten proceset e rekrutimit, riemërimi dhe avancimi të stafit akademik, si dhe atij administrativ;
 - *Infrastruktura fizike dhe digjitale*, paraqiten iniciativat në mirëmbajtjen dhe modernizimin e hapësirave ekzistuese, ashtu edhe në avancimin e projekteve të reja për ndërtimin e kampusit universitar, përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet qendrore dhe ato lokale;
 - *Profili akademik*, paraqiten ndryshimet në personelin akademik sipas fushave studimit bazuar në konkurset e shpallura sipas kërkesave të njësive akademike;
 - *Programet e studimit të nivelit*, paraqiten *akreditimet dhe riakreditimet e programeve studimore* të nivelit të studimeve bachelor dhe master, në të gjitha njësitë akademike, përfshirë hartimin e programeve të reja që adresojnë nevojat e tregut dhe zhvillimet bashkëkohore të arsimit të lartë;
 - *Numri i studentëve* (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit), organizimin e *dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj*, në përputhje me planifikimet akademike dhe kapacitetet e njësive përkatëse;
 - *Kërkimet shkencore*, paraqiten (*projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet*) paraqitet mbështetja e stafit akademik për publikimin e punimeve shkencore, në revista të indeksuara ndërkombëtarisht (SCOPUS dhe WoS), pjesëmarrjes në konferenca dhe ndarjes së çmimeve për kontributet shkencore;
 - *Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe projektet*, jep një pasqyrë të angazhimit të UKZ në nënshkrimin e marrëveshje të reja me universitete dhe institucione dhe projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, shkëmbime akademike dhe partneritete strategjike;
6. **Përfundimet**, paraqitet një përmbledhje e proceseve zhvillimore si arritjeve, *sfidave dhe objektivat për të ardhmen*, si dhe propozimin drejtimeve prioritare për zhvillim në vitin 2025 dhe më tej.
7. **Shtojcat/anekset** – përfshijnë tabela statistikore, dokumente mbështetëse, lista të rregulloreve të miratuara, dhe informata të tjera plotësuese.

Ky raport është përgatitur me kontributin e të gjitha njësive akademike, administrative dhe mbështetëse të universitetit, në koordinim me të gjitha divizionet e administratës qendrore. Raporti përfaqëson një përpyetje kolektive për të matur performancën institucionale dhe për të ndërtuar një universitet më të qëndrueshëm, më inovativ dhe më të hapur ndaj nevojave të studentëve dhe shoqërisë.

METODOLOGJIA E HARTIMIT

Raporti vjetor i punës për vitin 2024 i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan (UKZ) është hartuar mbi bazën e dokumenteve planifikuese dhe aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2024. Ky raport paraqet një përmbledhje gjithëpërfshirëse të veprimtarisë akademike, kërkimore, administrative dhe zhvillimore të universitetit gjatë këtij viti kalendarik.

Në fillim të procesit, në mbledhjen e kolegjiut të mbajtur më 21 shkurt 2024, u vendos që të krijohet një grup i gjerë punues. Ky grup përfshinte përfaqësues të Rektoratit (në nivel të prorektorëve), dekanët e njësive akademike, Sekretarin e Përgjithshëm dhe udhëheqësit e divizioneve të ndryshme. Qëllimi kryesor ishte mbledhja e të dhënave dhe materialeve të nevojshme për përgatitjen paraprake të raportit vjetor.

Më 13 mars 2024, rektori i UKZ-së, Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, formoi një grup më të ngushtë pune me këtë përbërje:

1. Prof. Dr. Naim Mustafa, kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Voglushe Kurteshi, anëtare
3. Isa Keka, anëtar
4. Valon Syla, anëtar
5. Minire Rexhepi, anëtare

Ky grup kishte për detyrë grumbullimin, analizimin dhe sistemimin e materialeve të dorëzuara nga prorektorët, dekanët dhe njësitë administrative. Pas ndarjes së detyrave brenda grupit, anëtarët punuan në bazë të fushave përkatëse për të përgatitur një dokument përfundimtar që reflekton punën e UKZ-së gjatë vitit 2024.

Pasi drafti final i raportit u përgatit, kryetari i grupit e dorëzoi atë te rektori, i cili më pas e procedoi dokumentin për shqyrtim në Këshillin Drejtues.

Në mbledhjen e mbajtur më datë 27 mars 2025, Këshilli Drejtues mori vendim për miratimin dhe publikimin e raportit. Njëkohësisht, u rekomandua që raporti t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), duke ndjekur procedurat e përcaktuara në Statutin e UKZ-së.

1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME STRATEGJIKE TË ARRITURA

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka vazhduar me përkushtim veprimtarinë e tij akademike, shkencore dhe institucionale, duke krijuar kushte të favorshme për studentët dhe stafin, si dhe duke forcuar rolin e tij si një qendër moderne e arsimit të lartë në rajon.

Në vazhden e misionit të tij, UKZ-ja ka punuar për të nxitur një kulturë të të nxënës, zhvillimit të dijeve, mendimit kritik dhe shpirtit ndërmarrës, me qëllim që të përgatisë të rinj të përgjegjshëm dhe profesionalisht të aftë për të qenë pjesë aktive e një shoqërie globale dhe tregu të hapur pune. Vizioni i universitetit është që të ndërtojë një profil akademik që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror dhe teknologjik, duke qenë një model frymëzues për komunitetin më të gjerë.

Bazuar në [Planin Strategjik 2023–2028](#), Universiteti ka përcaktuar një strategji të qartë dhe gjithëpërfshirëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha fushat e veprimit. Në këtë drejtim, janë identifikuar pesë objektiva strategjike që udhëheqin punën dhe orientimin e institucionit, në përputhje me nevojat e studentëve, tregut të punës dhe zhvillimeve shoqërore bashkëkohore:

Vizioni

Institucion i arsimit të lartë që synon cilësinë akademike, inovacionin, avancon dijen dhe është i përgatitur për të kontribuar dhe për t’iu përshtatur zhvillimeve dinamike shoqërore dhe ekonomike në vend dhe më gjerë.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2024, UKZ-ja ka realizuar përparime të konsiderueshme në këto pesë objektiva të përgjithshme strategjike:

1. *Ofrimi i programeve studimore cilësore në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin social;*
2. *Zhvillimi i aktivitetit shkencor dhe inovacionit, si mjet për përmirësimin e cilësisë së studimeve dhe avancimin akademik;*
3. *Ndërkombëtarizimi, si një komponent kyç për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të brendshme;*
4. *Përmirësimi i infrastrukturës, për të garantuar një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxënies efektive;*
5. *Zhvillimi i praktikave moderne të menaxhimit universitar, për një administrim efikas dhe transparent të institucionit.*

1. Objektivi strategjik: **Ofrimi i programeve studimore cilësore në raport me kërkesat e tregut dhe zhvillimin social**

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për të zhvilluar dhe përmirësuar cilësinë e programeve studimore, si dhe për të forcuar sistemin e brendshëm të menaxhimit akademik. Këto përpjekje kanë përfshirë hartimin e programeve të reja, riakreditimin e programeve ekzistuese dhe zbatimin e masave për rritjen e cilësisë akademike dhe administrative.

Akreditimet dhe riakreditimet e realizuara

Një nga arritjet më të rëndësishme ka qenë [riakreditimi institucional për një periudhë 5-vjeçare, 2024–2029](#), që konfirmon përkushtimin e universitetit për përmbushjen e standardeve të cilësisë. Përveç kësaj, gjatë vitit 2024 janë **akredituar dhe riakredituar gjithsej 9 programe studimore**, në disa fusha dhe nivele akademike:

1. [Fakulteti i Edukimit](#):

- Arsimi Parashkollor, BA (240 ECTS) – *riakredituar*
- Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, MA (60 ECTS) – *riakredituar*
- Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor, MA (60 ECTS) – *riakredituar*

2. [Fakulteti i Shkencave Kompjuterike](#):

- Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale, MA (120 ECTS) – *riakredituar*
- E-Qeverisja, MA (120 ECTS) – *riakredituar*

3. [Fakulteti Ekonomik](#):

- Financa dhe Kontabiliteti i Aplikuar, BSc (180 ECTS) – *riakredituar*
- Marketing dhe Menaxhim i Shitjes, BSc (180 ECTS) – *riakredituar*

4. [Fakulteti i Shkencave Sociale](#):

- Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Studimet Evropiane, BSc (180 ECTS) – *program i ri, akredituar për periudhën 2024–2027*

Programe në zhvillim dhe proces akreditimi

1. Është hartuar një *program i ri master në fushën e ekonomisë*, i cili aktualisht ndodhet në proces të akreditimit.
2. Fakulteti i Shkencave Aplikative është duke zhvilluar një *program të ri në fushën STEM (Matematika dhe STEM)*, gjithashtu në proces të akreditimit.

Planifikimi strategjik dhe vlerësimi i brendshëm

Të gjitha fakultetet kanë hartuar *Planet e veprimit për vitin akademik 2024/2025*, të cilat mund të konsultohen në faqet zyrtare përkatëse:

1. Plani i Veprimit – Fakulteti i Edukimit
<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-Veprimit-F.Edukimit.pdf>
2. Plani i Veprimit – Fakulteti Juridik
<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-veprimit-Fakultetit-Juridik.pdf>
3. Plani i Veprimit – Fakulteti Ekonomik
<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-veprimit-Fakulteti-Ekonomik.pdf>
4. Plani i Veprimit – Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-veprimit-Fakulteti-i-Shkencave-Kompjuterike.pdf>
5. Plani i Veprimit – Fakulteti i Shkencave Sociale
<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-Veprimit-FSHS.pdf>

Gjithashtu, janë *formuar grupe pune për analizimin e programeve ekzistuese*, me qëllim rishikimin e tyre dhe identifikimin e mundësive për reforma. Këto analiza janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik dhe Koordinatorët e Cilësisë, duke përfshirë *rishikimin e syllabuseve* në kuadër të procesit të riakreditimit.

Dokumente udhëzuese dhe manuale

Është përgatitur dhe publikuar *Manuali për hartimin e rezultateve të të nxënës*, i cili shërben si udhëzues për studentët dhe stafin akademik, duke sqaruar mënyrën e formulimit dhe arritjes së rezultateve të të nxënës në nivel kursi dhe programi:

- Manuali për rezultatet e të nxënës

<https://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2024/04/Manuali-Rezultatet-e-te-nxenit.pdf>

Trajnime dhe konsulta me palët e jashtme

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve akademike dhe rritjes së ndërgjegjësimit profesional, gjatë vitit akademik 2024–2025 janë organizuar *trajnimet për përdorimin e sistemit antiplagjiaturë* për stafin akademik dhe studentët:

- Trajnimi për sistemin antiplagjiaturë

<https://uni-gjilan.net/lajmet/realizimi-i-trajnim-per-sistemin-antiplagjiature-ne-universitetin-publik-kadri-zeka/>

Po ashtu, janë zhvilluar *anketime dhe konsulta me palët e jashtme të interesit*, për të vlerësuar nevojat e tregut të punës dhe për të matur kënaqësinë e studentëve të diplomuar. Rezultatet e këtyre konsultimeve janë reflektuar në rishikimin e programeve dhe në përgatitjet për riakreditim, duke siguruar që programet të jenë në përputhje me zhvillimet reale dhe kërkesat e tregut.

2. Objektivi strategjik: Zhvillimi i aktivitetit shkencor për përmirësim të cilësisë së studimeve dhe inovacion

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka intensifikuar përpjekjet për të fuqizuar aktivitetin shkencor dhe për të zhvilluar kapacitetet kërkimore në përputhje me objektivat strategjike dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë akademike.

Formimi i grupeve hulumtuese sipas fushave të specializuara

Një nga veprimet kyçe ka qenë krijimi i *grupeve hulumtuese brenda njësive akademike (NJA)*, të strukturuar sipas fushave të tyre kërkimore. Këto grupe kanë për qëllim të thelojnë bashkëpunimin ndërdisiplinor, të rrisin cilësinë e hulumtimeve dhe të shërbejnë si platforma për projekte të përbashkëta.

Publikime të indeksuara dhe përkrahje institucionale

Gjatë vitit 2024, janë financuar gjithsej **25 punime shkencore**, të cilat janë publikuar në platforma të njohura ndërkombëtare të indeksuara si *SCOPUS dhe Web of Science*. Ky është një tregues i qartë i përkushtimit të UKZ-së për të promovuar kërkimin cilësor me ndikim global. Shpërndarja e këtyre publikimeve sipas fakulteteve është si vijon:

1. *Fakulteti i Edukimit – 8 punime shkencore*
2. *Fakulteti Juridik – 11 punime*
3. *Fakulteti Ekonomik – 3 punime*
4. *Fakulteti i Shkencave Kompjuterike – 1 punim*
5. *Fakulteti i Shkencave Aplikative – 2 punime*

Përveç kësaj, janë financuar edhe 3 punime të veçanta shkencore të stafit akademik, të publikuara në revista të indeksuara në *SCOPUS dhe Web of Science*, që përfaqësojnë një arritje të rëndësishme në rritjen e vlerësimit shkencor të universitetit.

Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare

Stafi akademik është mbështetur për të marrë pjesë në *konferenca shkencore ndërkombëtare jashtë vendit*, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave, ngritjen profesionale dhe fuqizimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushat përkatëse.

Zhvillimi i mekanizmave për sigurimin e integritetit shkencor

UKZ ka siguruar një [softuer për kontrollin e plagjiaturës](#), me licencë për tri vite, që u shërben si stafit akademik ashtu edhe studentëve për të garantuar origjinalitetin dhe besueshmërinë e punimeve shkencore.

Përmirësimi i kuadrit rregullativ për kërkimin shkencor

Gjatë vitit është realizuar edhe *rishikimi i Rregullores për veprimtari shkencore*, me synimin për të përmirësuar procedurat dhe për të ofruar më shumë mbështetje për studiuesit, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Organizimi i Konferencës Shkencore Vjetore – [AC UKZ 2024](#)

Një nga ngjarjet kryesore të vitit ka qenë [Konferenca Shkencore Vjetore AC UKZ 2024](#), e cila u mbajt më 13 dhe 14 qershor 2024. Konferenca përfshiu 5 sesione tematike, të ndara sipas njësive akademike, me pjesëmarrjen e **124 studiuesve** që prezantuan punimet e tyre.

- **Libri i Abstrakteve** është publikuar në faqen zyrtare të konferencës dhe është pajisur me **ISBN dhe CIP** nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Shiko Librin e Abstrakteve <https://conference2024>.

Vlerësimi i ekselencës shkencore – çmimet [“Hulumtuesi i vitit”](#) dhe [“Marin Barleti”](#)

Në përpyetje për të motivuar stafin akademik dhe për të njohur kontributet e tyre, është organizuar **zgjedhja e Hulumtuesit të Vitit 2024**. Bazuar në kriteret e përcaktuara nga Senati i UKZ-së (Rregullorja për Veprimtari Shkencore, Vendimi nr. 01/431, datë 23.02.2024), [titulli i Hulumtuesit më të mirë për vitin 2023 iu dha Prof. Asoc. Dr. Naim Mustafa](#), i cili u nderua me mirënjohje nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku.

Po ashtu, **çmimi i UKZ-së “Marin Barleti”**, që synon të vlerësojë arritjet akademike dhe kontributet shkencore në arsimin e lartë, iu dha për vitin 2024 Prof. Dr. Blerim Rexhës, profesor në Universitetin e Prishtinës. Më shumë për çmimin “Marin Barleti” <https://conference2024.uni-gjilan.net/marin-barleti-award>.

Viti 2024 shënoi një fazë të rëndësishme zhvillimi për Universitetin Publik “Kadri Zeka” në fushën e hulumtimit shkencor. Aktivitetet e realizuara janë dëshmi e përkushtimit për të fuqizuar rolin e universitetit si promotor i dijes, inovacionit dhe ndikimit të drejtpërdrejtë në shoqëri dhe ekonomi.

3. Objektivi strategjik: **Ndërkombëtarizimi si element i zhvillimit të brendshëm**

Ndërkombëtarizimi përbën një komponent qendror në zhvillimin strategjik të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, duke reflektuar përkushtimin e institucionit për të integruar dimensionin global në të gjitha aspektet e funksionimit të tij akademik dhe organizativ. Gjatë vitit 2024, UKZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete që kanë rritur dukshëm profilin ndërkombëtar të universitetit dhe kanë përforcuar lidhjen me partnerë ndërkombëtarë në arsim, kërkim dhe inovacion.

Në kuadër të këtij objekti, janë realizuar këto rezultate kryesore:

- *Nënshkrimi i 18 marrëveshje të reja bashkëpunimi* me universitete dhe institucione evropiane, rajonale dhe vendore, që mbulojnë fusha të tilla si mobiliteti akademik, kërkimi shkencor, digjitalizimi, klinikat ligjore dhe zhvillimi institucional.
- *Pjesëmarrje aktive në mbi 15 projekte ndërkombëtare*, përfshirë projekte të financuara nga programet Erasmus+, HERAS+, IPA, UNHCR, Banka Botërore dhe qeveria zvicerane.
- *Zhvillimi i 6 projekteve të reja të nisura në vitin 2024*, përfshirë REISSE UP, EMPHASIS, EDUFAIR, STEM Europe, DELTA dhe TIKA-Cezeri Lab.
- *Aplikimi me 14 projekte të reja ndërkombëtare* në thirrjet për CBHE dhe Jean Monnet, me tematika që përfshijnë të drejtat sociale, bujqësinë e qëndrueshme, migracionin dhe digjitalizimin.

Përmes marrëveshjeve të mobilitetit ICM Erasmus+, UKZ ka realizuar *shkëmbime studentore dhe të stafit akademik dhe administrativ me universitete nga mbi 10 vende evropiane*, përfshirë Zvicrën, Poloninë, Francën, Bullgarinë, Italinë, Spanjën, Turqinë dhe Portugalinë. Ndërkohë, pjesëmarrja në *konferenca, forume dhe trajnime ndërkombëtare*, si Konferenca e Rektorëve të Evropës Juglindore, Konferenca BRIDGE dhe ngjarjet e Jean Monnet, kanë rritur ndjeshëm vizibilitetin dhe integrimin ndërkombëtar të universitetit.

Në aspektin e sfidave, UKZ ka identifikuar nevojën për:

- Rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare;
- Krijimin e platformave të qëndrueshme për mbështetjen e mobilitetit dhe shkëmbimeve;
- Rritjen e burimeve financiare për pjesëmarrjen e gjerë të stafit dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare.

Objektivat për vitin 2025 përfshijnë:

- Zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimeve me universitete elitare nga BE dhe SHBA;
- Rritjen e numrit dhe cilësisë së projekteve kërkimore të përbashkëta;

- Ngritjen e një sistemi digjital për menaxhimin e mobilitetit dhe bashkëpunimit;
- Përmirësimin e mbështetjes institucionale për publikime dhe konferenca ndërkombëtare.

Përmes këtyre hapave, Universiteti Publik “Kadri Zeka” synon të forcojë më tej pozicionin e tij si një qendër e dijes dhe inovacionit në rajon, duke i ofruar studentëve dhe stafit një ambient akademik të hapur, bashkëkohor dhe ndërkombëtar në përmbajtje dhe frymë.

4. Objektivi strategjik: **Krijimi i kushteve infrastrukturore për mësim cilësor**

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka shënuar progres të konsiderueshëm në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për krijimin e kushteve infrastrukturore që mundësojnë një mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Përmes një sërë iniciativash konkrete, institucioni ka synuar të përmirësojë ambientin akademik dhe të krijojë hapësira më funksionale për studentët dhe stafin universitar.

Në këtë drejtim, UKZ ka vënë theksin si në mirëmbajtjen dhe modernizimin e hapësirave ekzistuese, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve të reja në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale. Një nga arritjet kryesore të këtij viti është miratimi i dokumentit strategjik “*Strategjia e zgjerimit dhe rikonstruktimit të hapësirave ekzistuese 2025–2027*”, e cila është ndërtuar mbi një analizë të thelluar të sfidave infrastrukturore me të cilat përballlet universiteti.

Strategjia zhvillimore përqendrohet në dy shtylla themelore:

1. **Ndërtimi i një kampusi modern universitar**, që do të përfshijë hapësira për të gjitha njësitë akademike dhe administrative, të projektuara sipas standardeve bashkëkohore;
2. **Rimodelimi dhe rikonstruktimi i infrastrukturës ekzistuese**, me qëllim optimizimin e përdorimit të saj dhe krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për mësim, punë dhe shërbime ndaj studentëve.

Zbatimi i kësaj strategjie kërkon një qasje të planifikuar dhe të koordinuar, përmes hartimit të një studimi të fizibilitetit dhe një master-plani të detajuar, që do të shërbejë si udhërrëfyes për fazat e implementimit. Ky plan do të përfshijë identifikimin e burimeve të financimit, bashkëpunimin me partnerët institucionalë dhe përcaktimin e hapave konkretë për realizimin e projekteve infrastrukturore.

Nëse mbështetja financiare sigurohet në fillim të vitit 2025, parashikohet që realizimi i kësaj strategjie të zgjasë 3 deri në 4 vite. Megjithatë, përvoja me projektet publike tregon se burokracia dhe mungesa e burimeve të qëndrueshme financiare mund të ndikojnë në ritmin e zbatimit. Për këtë arsye, një bashkëpunim i ngushtë dhe i vazhdueshëm me institucionet shtetërore dhe ato lokale është jetik për të garantuar suksesin dhe qëndrueshmërinë e këtij procesi transformues për UKZ-në.

Pjesëmarrja në projektin e financuar nga Banka Evropiane për Investime (BEI)

Një nga aktivitetet më të rëndësishme në këtë drejtim ka qenë pjesëmarrja e UKZ-së në projektin e financuar nga [*Banka Evropiane për Investime \(BEI\)*](#) – “*Vlerësimi i fizibilitetit dhe nevojave për institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë*”, i implementuar nga konsorciumi i udhëhequr nga SOFRECO. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë **MASHTI-n** në përmirësimin e standardeve të infrastrukturës për arsimin e lartë publik dhe të përforcojë ofrimin e shërbimeve akademike.

Gjatë periudhës janar–qershor 2024, UKZ ka bashkëpunuar me ekipin e ekspertëve përmes takimeve dhe vizitave në terren, duke ofruar dokumentacionin e nevojshëm dhe duke mundësuar një vlerësim të detajuar të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës. Si rezultat, ekspertët kanë rekomanduar ndërtimin **urgjent** të një objekti të ri për kampusin universitar të UKZ-së.

Përfshirja në projektet WBIF dhe mbështetja nga MASHTI

Në përputhje me këtë rekomandim, [*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit \(MASHTI\)*](#) ka njoftuar UKZ-në se ndërtimi i kampusit të ri është përfshirë në përgatitjet për aplikim në projektet e **Western Balkans Investment Framework (WBIF)**. Ky projekt është vendosur si prioritet dhe është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës si një ndër investimet strategjike në fushën e arsimit të lartë.

Koordinimi me autoritetet lokale dhe procedurat për ndërtimin e kampusit

Menaxhmenti i Universitetit, në [*koordinim të ngushtë me Komunën e Gjilanit*](#), ka filluar procedurat administrative për ndërtimin e kampusit të ri. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur takime me kryetarin e komunës së Gjilanit dhe drejtoritë përkatëse të komunës (urbanizëm, gjeodezi, planifikim, mjedis dhe shërbime publike), si dhe janë dorëzuar *tri kërkesa zyrtare* lidhur me projektin (në datat 30 tetor dhe 3 dhjetor 2024). [*Pritet që në tremujorin e parë të vitit 2025*](#) të përfundojnë procedurat administrative dhe të nisë zbatimin e projektit.

Rinovimi i hapësirave të Rektoratit

Në kuadër të përmirësimit të [*infrastrukturës ekzistuese*](#), është realizuar projekti për [*rinovimin e hapësirave të Rektoratit*](#), duke përfshirë:

- Përmirësimin e tualeteve,
- Zëvendësimin e trupave ndriçues në hyrjet A dhe B të ndërtesës.

Ky projekt ka kaluar përmes fazave të inicimit, miratimit dhe prokurimit, përfshirë zgjedhjen e operatorit ekonomik dhe përmbylljen me pranimin e punimeve nga komisioni përkatës. Një pjesë e projektit – *zgjerimi i parkingut* – do të realizohet gjatë vitit 2025 pas marrjes së pëlqimit nga

komuna. Po ashtu, janë përmbushur obligimet financiare për operatorët, ndërsa një pjesë e shpenzimeve është bartur për vitin e ardhshëm.

Projektet e planifikuara: Qendra STEM

Për vitin 2025 është planifikuar ndërtimi i **Qendrës STEM**, e cila do të shërbejë si një hapësirë e specializuar për zhvillimin e fushave të Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës. Qendra do të krijojë kushte për kërkime të avancuara dhe mësim bashkëkohor në fushat STEM, duke ndihmuar në modernizimin e ofertës akademike dhe ngritjen e kapaciteteve shkencore të universitetit.

5. Objektivi strategjik: Zhvillimi i praktikave efektive menaxheriale

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” ka ndërmarrë një sërë aktivitete për përmirësimin e menaxhimit të brendshëm institucional, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, rishikimin e rregulloreve të brendshme dhe forcimin e praktikave të sigurimit të cilësisë. Këto veprime synojnë rritjen e efikasitetit menaxherial dhe përmirësimin e mjedisit akademik për stafin dhe studentët.

Rishikimi dhe hartimi i rregulloreve institucionale

Një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit menaxherial ka qenë rishikimi dhe përmirësimi i rregulloreve ekzistuese që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e universitetit. Gjatë vitit 2024, janë rishikuar dhe miratuar rregullore të rëndësishme si:

1. [Rregullorja për procedurat përzgjedhëse në emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik;](#)
2. [Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratë \(dy herë e përditësuar\);](#)
3. [Rregullorja për studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Sociale;](#)
4. [Rregullorja për funksionimin e Divizionit për Zhvillim të Karrierës dhe Alumni;](#)
5. [Rregullorja për caktimin e shpenzimeve për përfaqësime zyrtare;](#)
6. [Rregullorja për përdorimin e telefonisë dhe menaxhimin e shpenzimeve për përfaqësim;](#)
7. [Rregullorja për veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe funksionimin e Këshillit Botues të Universitetit](#)

Gjithashtu, është themeluar grupi punues për *rregulloren mbi disiplinën e stafit akademik dhe studentëve*, dokument i cili është draftuar dhe është në proces miratimi. Ky dokument do të garantojë një qasje më të qartë dhe të standardizuar në trajtimin e çështjeve disiplinore.

Zbatimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë

Në kuadër të angazhimeve për sigurimin e cilësisë, është zbatuar pjesërisht *plani vjetor për vlerësimin e lëndëve/kurseve, administratës dhe punës kërkimore-shkencore*. Janë përgatitur raportet nga studentët dhe Zyra për Zhvillim të Cilësisë (ZZHAC), si dhe janë ndërmarrë hapa për zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë akreditimit institucional dhe riakreditimit të programeve.

Është hartuar edhe raporti për *çregjistrimin dhe diplomimin e studentëve* për vitin 2024, që ofron një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e studimeve dhe administrimin e cikleve akademike.

Zhvillimi profesional i stafit akademik dhe administrativ

Për çdo vit akademik, UKZ harton ***Planin e zhvillimit profesional***, i cili përfshin:

- Identifikimin e nevojave përmes Planeve Zhvillimore Individuale (PZHI);
- Hartimin e planeve të trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ;
- Përcaktimin e kornizës së zhvillimit profesional për rritjen e kompetencave dhe përgatitjen për sfida të reja.

Këto veprime synojnë të rrisin performancën institucionale dhe të kontribuojnë në ngritjen e standardeve akademike dhe administrative.

Mbështetja për studentët dhe aktivitetet ndërkombëtare

Një tjetër komponent i rëndësishëm ka qenë *përkrahja e studentëve* në pjesëmarrje ndërkombëtare, veçanërisht në gara dhe olimpiada të lidhura me aftësitë digjitale dhe shkencat kompjuterike. Kjo ka ndihmuar në zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të reja dhe në promovimin e imazhit të universitetit në arenën ndërkombëtare.

Riakreditimi institucional dhe programet e reja akademike

Riakreditimi institucional

Gjatë vitit 2024, UKZ ka kaluar me sukses procesin e ***riakreditimit institucional***. Më 8 shkurt 2024, ekipi i ekspertëve të jashtëm, së bashku me përfaqësues nga *Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)*, realizuan vizitën zyrtare në universitet. Si rezultat, [UKZ ka fituar akreditim për](#)

[një periudhë pesëvjeçare: 01.10.2024 – 30.09.2029](#), duke konfirmuar përmbushjen e standardeve akademike dhe administrative.

Aplikimi për programe të reja akademike

Përveç riakreditimit të programeve ekzistuese, UKZ ka aplikuar për akreditimin e **dy programeve të reja master**:

1. [Analiza Ekonomike dhe Politika Zhvillimore](#) – master
2. [Mësimdhënie në Gjuhën Angleze](#) – master

Këto programe synojnë të adresojnë nevojat e tregut të punës dhe të kontribuojnë në diversifikimin dhe avancimin e ofertës akademike të institucionit.

Viti 2024 ka qenë një periudhë e rëndësishme për forcimin e praktikave të menaxhimit në Universitetin Publik “Kadri Zeka”. Aktivitetet e ndërmarra kanë konsoliduar infrastrukturën institucionale, kanë përmirësuar rregulloret dhe procedurat, dhe kanë krijuar një mjedis më funksional dhe efikas për realizimin e misionit akademik dhe kërkimor të universitetit.

2. PUNA E ORGANEVE QEVERISËSE

Gjatë vitit 2024, organet qeverisëse të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, përkatësisht [Këshilli Drejtues](#) dhe [Senati](#), kanë ushtruar funksionet e tyre në përputhje me mandatin ligjor dhe Statutin e universitetit. Aktivitetet e tyre janë karakterizuar me marrjen e vendimeve strategjike, miratimin e dokumenteve të rëndësishme, rregulloreve institucionale, si dhe me monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimeve akademike, buxhetore dhe administrative.

2.1. Të dhëna për Këshillin Drejtues

Gjatë vitit 2024, [Këshilli Drejtues \(KD\)](#) ka mbajtur gjithsej **nëntë (9) mbledhje**, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar:

- Nëntë (9) rende dite dhe procesverbale,
- Dyzet (40) vendime të ndryshme,
- Planifikimi buxhetor për vitin 2024, si dhe vlerësimet për vitet 2025 dhe 2026,
- Raportet financiare tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore për shpenzimet e buxhetit.

Komisionet dhe ankesat

- KD ka formuar *Komisionin për parashtrëse dhe ankesa*, i cili ka trajtuar dhe zgjidhur të gjitha çështjet e ngritura në drejtim të KD-së.
- Edhe pse janë trajtuar të gjitha ankesat, nuk është nxjerrë një raport përmblledhës i veçantë mbi to.

Zgjedhja e prorektorëve

KD ka miratuar [zgjedhjen e prorektores së Universitetit, Prof. Asoc. Dr. Shpresë Qamili](#).

Vendime për mbështetje financiare

KD ka miratuar ndarjen e 180,000.00 euro nga *kategoria e subvencioneve dhe transfereve*, të shpërndara si më poshtë:

- 1) 78,000.00 € për bursa studentore;
- 2) 40,000.00 € për mbështetje të kërkimeve shkencore për stafin akademik;
- 3) 10,000.00 € për mbështetje të studentëve;

- 4) 3,000.00 € për studentë elitarë;
- 5) 3,789.00 € për mbështetje të studentëve në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Miratimi i rregulloreve të brendshme

Gjatë vitit, KD ka miratuar këto rregullore:

1. [Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin](#) e vendeve të punës në administratë;
2. [Rregullorja për veprimtarinë dhe kërkimet](#) shkencore;
3. [Rregullorja për shpenzimet e reprezentacionit](#) (dreka, darka, etj.);
4. [Rregullorja për përdorimin e telefonisë](#) në UKZ;
5. [Rregullorja për funksionimin e Divizionit për Zhvillimin e Karrierës](#) dhe Alumni.

[Vendime](#) të tjera të Këshillit Drejtues:

1. Shpallja e konkursit dhe zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm të UKZ-së;
2. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të KD-së;
3. Formimi i komisionit për çështje statutare;
4. Themelimi i grupit për planifikimin vjetor dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë;
5. Formimi i komisionit për procedura dhe masa disiplinore;
6. Shpallja e konkursit për bursë universitare;
7. Miratimi i Planit të Veprimit 2024–2025;
8. Organizimi i Konferencës Shkencore Vjetore të UKZ-së;
9. Dhënia e konkluzioneve dhe rekomandimeve për çështje të ndryshme institucionale.

2.2. Të dhëna për Senatin

[Senati i UKZ-së](#), gjatë periudhës raportuese, ka mbajtur gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) mbledhje dhe ka miratuar:

- Shtatëmbëdhjetë rende dite dhe procesverbale;
- Shtatëdhjetë (70) vendime të ndryshme;

Miratimi i rregulloreve

Senati ka miratuar *njëmbëdhjetë (11) rregullore*, të harmonizuara me Statutin e ri të UKZ-së, duke përfshirë ndër të tjera:

1. [Rregullorja për procedurat përzgjedhëse për emërimin, riemërimin dhe avancimin e stafit akademik](#) (Ref. nr. 01/1328, dt. 26.06.2024);
2. [Rregullorja për studimet themelore – baçelor në Fakultetin e Shkencave Sociale](#) (Ref. nr. 01/2779, dt. 19.11.2024);
3. [Rregullorja për punën e Këshillit Botues](#) (Ref. nr. 01/2, dt. 03.01.2025).

Akreditimi institucional dhe programeve të studimit

1. Senati ka miratuar vendimin për aplikimin për **akreditimin institucional të UKZ-së**.
2. Janë miratuar propozimet për **akreditimin dhe riakreditimin** e programeve studimore të sjella nga Këshillat e Fakulteteve.

Procesi i [rekrutimit të stafit akademik](#)

Janë miratuar propozimet për shpalljen e konkurseve për:

- Emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik për vitin 2024;
- Angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për semestrin dimëror dhe veror.

Vendime të tjera të Senatit:

1. Miratimi i numrit të studentëve për regjistrim në vitin e parë;
2. Shpallja e konkursit për pranimin e studentëve të rinj;
3. Vendimet për përzgjedhje në pozita akademike dhe administrative;
4. Shpallja e Hulumtuesit të Vitit;
5. Miratimi i afateve të provimeve dhe kritereve për bursa;
6. Emërimi i katër anëtarëve të rinj në Këshillin Drejtues nga radhët e Senatit;
7. [Fillimi i procedurave për ndarjen e titullit *Doctor Honoris Causa*](#) ish presidentit George W. Bush

3. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME STATISTIKORE

3.1. Buxheti (fondet publike dhe private)

[Raporti vjetor i buxhetit](#) paraqet një përmbledhje të të hyrave dhe shpenzimeve të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan për periudhën *janar–dhjetor 2024*. Ky raport është përgatitur nga Zyra për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrat e Certifikuese dhe Zyrën e Prokurimit, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar të institucioneve publike.

Raporti financiar përmban të dhëna të detajuara mbi realizimin e buxhetit dhe strukturën e shpenzimeve, përfshirë fondet publike të alokuara dhe menaxhimin e tyre në përputhje me planet operationale dhe objektivat e universitetit.

Miratimi i raportit buxhetor

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 11 shkurt 2025, ka miratuar *Raportin e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2024 (Vendimi nr.02/354, datë 19.02.2025)* duke vlerësuar realizimin dhe përputhjen e tij me dispozitat buxhetore dhe objektivat institucionale.

Të dhëna të përgjithshme mbi realizimin e buxhetit

Gjatë vitit 2024, *realizimi i përgjithshëm i buxhetit* ka qenë në nivelin 103.37 %, që tregon një shfrytëzim efektiv të burimeve financiare në dispozicion. Struktura e realizimit sipas kategorive kryesore të shpenzimeve është si më poshtë: Paga dhe shtesa 122.16 %, Mallra dhe shërbime 90.98 %, Shpenzime komunale 35.12 %, Transfere dhe subvencione 63.48 %, Shpenzime kapitale 81.36 %.

Shpjegime për tejkalimet buxhetore në kategori të caktuara

Tejkalimi në kategorinë “*Paga dhe shtesa*”, në masën 122.16 %, ka ndodhur si rezultat i zvogëlimit të buxhetit në këtë kategori përmes qarkores së parë buxhetore të vitit 2024, ku u evidentua një *zbritje prej 26.87 %* krahasuar me vitin paraprak. Konkretisht, në vitin 2023 buxheti për këtë kategori ishte 1,535,281.00 €, ndërsa në vitin 2024 ishte 1,122,733.00 €, që përbën një diferencë negative prej 412,548.00 €. Megjithatë, ky deficit është kompensuar me vonë përmes *çekut buxhetor të ndarë nga Qeveria* në muajt nëntor dhe dhjetor 2024, duke siguruar që universiteti të mos ketë mbetur me detyrime financiare të papaguara në këtë kategori.

Në tabelën vijuese është paraqitur buxheti dhe shpenzimet deri më 31.12.2024 si dhe struktura e shpenzimeve në raport me gjithsejtë buxhetin.

Tabela 1. Buxheti dhe shpenzimet janar –dhjetor 2024

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar për 2024	Shpenzimet 01.01 - 31.12.2024	Pjesëmarrja në % e shpenzimeve sipas kategorive në buxhetin total
Paga dhe shtesa	1,122,733.00 €	1,371,526.34 €	122.16%
Mallra dhe shërbime	476,923.00 €	433,909.41 €	90.98%
Shpenzime komunale	50,000.00 €	17,562.37 €	35.12%
Subvencione dhe transfere	185,000.00 €	117,430.53 €	63.48%
Pasuritë jo financiare (kapitale)	200,000.00 €	162,724.01 €	81.36%
Totali	2,034,656.00 €	2,103,152.66 €	103.37%

Në përfundim, realizimi buxhetor për vitin 2024 tregon një menaxhim të kujdesshëm dhe të qëndrueshëm financiar nga ana e UKZ-së, përkundër sfidave që janë shfaqur gjatë vitit, veçanërisht në kategorinë e pagave. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet qendrore dhe përkushtimi për menaxhim të përgjegjshëm financiar kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit buxhetor dhe përmbushjen e objektivave operationale të universitetit.

Fondet burimore të buxhetit në UKZ

Gjatë periudhë raportuese janar – dhjetor 2024, shpenzimet e Universiteti Publik “Kadri Zeka” Gjilan janë mbuluar nga dy fonde burimore të buxhetit:

1. *Fondi burimor 10 (granti qeveritar)*
2. *Fondi burimor 49 (projektet ndërkombëtare)*

Tabela 2. Fondet burimore

Buxheti i UKZ	Shpenzimet janar - dhjetor 2024
Fondi burimor 10	2,103,152.66 €
Fondi burimor 49 (projektet)	184,952.06 €
Totali	2,288,104.72 €

Të hyrat vetanake

Universiteti publik “Kadri Zeka” për periudhën raportuese janar – dhjetor 2024 ka krijuar të hyra vetanake¹ në shumën prej 57,269.50 euro – participimet e studentëve të UKZ-së.

Tabela 3. Të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake	janar - dhjetor 2024
Janar	3,862.50 €
Shkurt	12,606.00 €
Mars	3,670.00 €
Prill	2,790.00 €
Maj	830.00 €
Qershor	3,686.00 €
Korrik	2,967.50 €
Gusht	1,040.00 €
Shtator	3,697.50 €
Tetor	16,400.00 €
Nëntor	3,337.50 €
Dhjetor	2,382.50 €
Totali	57,269.50 €

Të hyrat vetanake të UKZ-së janë mjete financiare që grumbullohen duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës si dhe Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovës. Këto të hyra grumbullohen nga pagesat e studentëve si: Pagesa e semestrit, pagesat e vërtetimeve, pagesat e regjistrimeve etj.

Buxheti i projekteve ndërkombëtare

Buxheti i projekteve për periudhës raportuese janar – dhjetor 2024 paraqitet në tabelën vijuese:

¹ Universiteti publik “Kadri Zeka” nuk i shfrytëzon - menaxhon të hyrat vetanake.

Tabela 4. Shpenzimet dhe buxheti i projekteve (fondi burimor 49)

Akronimi – Projektet ndërkombëtare	Buxheti 2024	Shpenzimet 2024	Mjetet e pashfrytëzuara	Përqindja e shpenzimeve
GREEWEB	55,440.27 €	27,054.00 €	28,386.27 €	48.80 %
SIAHPCD	10,222.82 €	10,085.64 €	137.18 €	98.66 %
STAND	20,121.95 €	11,726.46 €	8,395.49 €	58.28 %
WEBYOU	28,836.42 €	28,816.95 €	19.47 €	99.93 %
QATEK	9,672.43 €	9,631.05 €	41.38 €	99.57 %
QUADIC	76,958.68 €	76,958.62 €	0.06 €	100.00 %
SUSWELL	3,225.00 €	3,221.03 €	3.97 €	99.88 %
REACHERCULT	2,148.41 €	2,145.99 €	2.42 €	99.89 %
ENEMLOS	21,170.30 €	15,312.32 €	5,857.98 €	72.33 %
EDUFAIR	30,174.70 €	0.00 €	30,174.70 €	0.00 %
TOTALI	257,970.98 €	184,952.06 €	73,018.92 €	71.69 %

KATEGORITË KRYESORE TË BUXHETIT (Fondi Burimor 10)

Paga dhe shitesa

Në kategorinë **“Paga dhe shitesa”**, për periudhën raportuese 12 mujore, janë shpenzuar gjithsejtë **1,371,526.54 €**. Këtu përfshihen pagesa neto e pagave, honorarëve, mbi normave, pagesa për kontribute pensionale 5% , pagesa e tatimit të ndalur në burim për të gjithë punonjësit e rregullt të UKZ-së si dhe kontributi pensionale në shkallë prej 5 % për punonjësit e angazhuar ne projektet. Vlen të theksojmë që në këtë kategori nuk përfshihen punonjësit me kontratë për shërbime të veçanta dhe të gjitha pagesat tjera për punonjës jashtë listës – sistemit qeveritar të pagesave (PAY ROLL).

Tabela 5. Paga dhe shtesa

Përshkrimi	Shpenzimi nga BKK
Neto pagat	863,081.95 €
Tatimi në të ardhurat personale	96,879.35 €
Kontributet pensionale - punëtori	64,169.46 €
Sindikata	1,162.24 €
Përvoja e punës	53,665.26 €
Kontributet pensionale - punëdhënësi	64,169.46 €
Kujdestari, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punës	191,082.23 €
Funksionaret me kohe te pjesshme	3,010.40 €
Shtesat tranzitore	32,109.57 €
Vendimi gjyqësore	2,196.62 €
Totali	1,371,526.54 €

Mallra dhe shërbime

Në këtë kategori buxheti fillestar për vitin 2024 është në shumë prej **476,923.00 €**. Përmes kësaj kategorie UKZ-ja paguan shpenzimet fikse ashtu edhe ato variabile si p.sh. kontratat për pastrimin-mirëmbajtjen e objektit, sigurimi i objektit, shërbimet kontraktuale, pagesa e mbushjeve të telefonave mobil, avance për udhëtime zyrtare, etj.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, për periudhën raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2024), janë shpenzuar gjithsejtë **433,909.41 €²**.

² Shih Aneks Raportin – për detajet dhe procedurat e raportit në prokurimit

Tabela 6. Mallra dhe shërbime

Kategoria e shpenzimit	Totali	Përqindja %
Shërbimet e telekomunikimit-Vala (mbushjet tel për menaxhmenti në vlerë prej 7,170.00 € dhe pagesa për tel. mobile për administratën e UKZ në vlerë 1,344.68 €. <i>Sqarim:</i> Sipas rekomandimit të auditorit kemi bërë harmonizimin dhe ndryshimin e dy (2) rregulloreve përfshirë edhe atë për mbushje të telefonisë mobile. Gjatë vitit fiskal 2025 do të kemi një rritje të këtyre shërbimeve, bazuar në plotësim ndryshim e Rregullores për mbushje të telefonisë mobile.	8,514.68 €	1.96 %
Shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit (menaxhmenti, stafi akademik, administrativ dhe studentet).	3,751.96 €	0.86 %
Transporti jashtë vendit (Prime Tours Travel 620.00 euro për bilete avioni, Atravie travel SHPK 897.00 euro biletat e avionit dhe mbulimi i shpenzimeve të transportit për dy mysafirët në konferencën shkencore, 200.00 euro për person).	2,652.60 €	0.61 %
Akomodimi jashtë vendit (menaxhmenti dhe stafin akademik)	9,319.55 €	2.15 %
Para xhepi / mëditje (menaxhmenti dhe stafin akademik e administrativ) <i>Sqarim:</i> Për periudhën janar – dhjetor 2024 janë hap advance për 9 udhëtime zyrtare. Në këto udhëtimi ishin pjesëmarrës gjithsej 17 veta (shih aneks sqarimin).	8,746.54 €	2.02 %
Shpenzimet brenda vendit (shfrytëzimi i veturave privat nga stafi administratës dhe stafi akademik në mungesë të veturës zyrtare) dhe akomodimi brenda vendit.	788.30 €	0.18 %
Shërbime Shtypje/Printim (Gani Kastrati BI 976.00 euro, Gentiana Syla BI 99.00 euro, Lumi press 99.00 euro dhe 3E Desing SHPK 1,731.70 euro). <i>Sqarim:</i> Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me materiale promovuese lidhur me aktivitetet e ndryshme të UKZ përfshirë konferencën vjetore shkencore si dhe materiale tjera për informim dhe sensibilizim të opinionit publik.	4,142.90 €	0.95 %
Shërbimet kontraktuale (kontributet pensionale 5% për të angazhuarit në projekte), pagesat e tatimi në burim 8,508.70 dhe pagesat për komisione dhe senator - studentet) Sqarim: Në këto shërbime përfshihen edhe shujtat për administratë që janë paguar për vitin 2024 dhe në këtë kategori për vitin fiskal 2025 do të paguhet shujtat e stafit akademik.	28,127.12 €	6.48 %

Shërbime teknike (Rexhep Sylejmani BI 1,975.000 Euro projektimi për renovim hyrja A dhe KNN Project SHPK 980.00euro, projektimi i projektit për renovim hyrja B, CEO SHPK 531.00 euro dhe Dëfrim Behluli ne vlere prej 99.00 euro për shërbime teknike në përvjetorin e UKZ etj.	3,833.00 €	0.88 %
Furnizim me pije dhe ujë (kontrate e rregullt me kompaninë Dauti Komerce SHPK 547.00 euro, dhe furnizim me pije për komisione mbledhje, etj.) Kompani e kontraktuar nga AQP-ja.	1,468.83 €	0.34 %
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve (Servisimi i veturave zyrtare 796.00 euro, Sali Sejdullahu BI 86.00 euro mirëmbajtja e veturave), Eurogoma SHPK dhe Tafa S SHPK 997.00 euro.	2,610.20 €	0.60 %
Sigurimi i objektit , mujore 2,276.83 euro (Drita Security SHPK kontrate e rregullt)	27,321.96 €	6.30 %
Karburant për vetura (HIB Petroll, kontratë e rregullt)	2,890.59 €	0.67 %
Softuerët dhe mirëmbajtja e tyre - Kontrata e rregullt me Uni Soft SHPK mujore 4,400.00 euro, Fastspint 56.40 euro dhe softueri antiplagjiatur 19,425.50 euro	63,508.90 €	14.64 %
Mirëmbajtja e objektit - Pastrimi (kontrata e rregullt Aroma Plus SHPK mujore 4,487.00 euro dhe Sevdije Basha BI 99.00 mirëmbajtje), etj.	53,362.70 €	12.30 %
Pajisjet të tjera dhe të IT (Pattern SHPK 12,158.20 euro, Gjirafa 79.50 euro maus, Entech Systems 540.00 euro dhe AS TECH SHPK 19,930.00 euro) etj. <i>Sqarim:</i> Nga kompania PATTERN SHPK është bërë furnizimi me materiale të ndryshme të IT-së për nevoja të universitetit si p.sh harddisqe, ram memorie, printer për shtypje të tabelave, kablllo të HDMI etj. <i>Qëllimi i këtij furnizimi</i> është për nevoja të mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së dhe për funksionalizimin e sallave të mësimet. AS TECH përfshin furnizimin me klima për UKZ.	33,887.70 €	7.81 %
Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit <i>Sqarim:</i> Ky kod sipas Planit të ri kontabël të vitit 2024 është riemërua ish kodi dreka zyrtare/shpenzimet e reprezentacionit / Drekat zyrtare me përfaqësues të brendshëm dhe të jashtëm.	9,834.21 €	2.27 %
Shpenzimet e anëtarësimit (MASHTI/AKA - Akreditimi Institucional 63.500.00 euro, European Law faculties (ELFA) ne vlere prej 450.00 euro, European University Foundation 1,500.00 euro, Univerza V Ljubjana në vlerë prej 1,000.00 euro, European Network for Academ Intergrity 350.00 euro dhe ATEE AISBL 240.00 euro)	67,040.00 €	15.45 %

Furnizim për zyre (Almir Abdyli BI Furnizim me material administrativ dhe informues për UKZ 991.15 euro, Gi Grafo Loni SHPK, letër universale për kopje A4 2,720.00 euro, Agmia Center SHPK 98.06 euro furnizim për rektorat, lulishtja Mani 99.00 dhe Oniks Shpk 98.00 euro) etj.	4,166.77 €	0.96 %
Kompjuter (me pak se 1,000.00 euro) Botek SHPK 23,436.00 euro dhe CGS SHPK 17,380.00 euro. Sqarim: Furnizim me kompjuter ALL IN ONE për nevoja të kabinetit të informatikës në FSHK.	40,816.00 €	9.41 %
Karburant për nxehjen qendrore (HIB Petroll shpk, kontratë e rregullt)	52,506.78 €	12.10 %
Sigurimi dhe regjistrimin e veturave zyrtare	1,228.99 €	0.28 %
Shërbime arsimore dhe trajnime (Future Minds llc - stafi administrativ 2 persona)	180.00 €	0.04 %
Mirëmbajtja e IT-së <i>Sqarim:</i> (OffiShop SHPK 995€) dhe Servisimi i fotokopjeve nëpër njësi akademike; Rikon 95€)	1,090.00 €	0.25 %
Mirëmbajtje Rutinore (Dua Arch SHPK 984.93 euro dhe Ngrohja SHPK 996.40 euro) <i>Sqarim:</i> Furnizim me materiale të ndryshme për mirëmbajtje të sanitarisë, ngrohjes qendrore si dhe parkut të kampusit.	1,981.33 €	0.46 %
Reklama dhe konkurse (Publikimi i konkursit Muhamet Mavraj BI 98.00 euro)	98.00 €	0.02 %
Shërbime Postare	39.80 €	0.01 %
TOTALI	433,909.41 €	100.00 %

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale janë shpenzuar në bazë të faturave dhe përbëjnë shpenzime që ndodhin çdo vit, thuajse në masën e njëjtë, pa ndryshime të mëdha. Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore (Janar – Dhjetor 2024), janë shpenzuar gjithsejtë **17,562.37 €**.

Në vijim është paraqitur tabela me shpenzime për secilin operator ekonomik.

Tabela 7. Shpenzimet komunale

Kategoria e shpenzimit	Shuma e shpenzuar janar - dhjetor 2024
Telefonia fikse	1,661.41 €
KESCO	12,160.10 €
Hidromorava	2,970.82 €
Eco-higjiena	770.04 €
Totali	17,562.37 €

Subvencionet dhe transfere

Në këtë kategori bëhet pagesat e bursave për studentët e dalluar, mbështetja e kërkimeve dhe publikimeve shkencore për stafin akademik, hulumtuesi i vitit, si dhe aktivitete të ndryshme gara, recitimet, përfaqësime nga studentet, mobilitet etj. Nga kjo kategori për periudhën raportuese 12 mujore, kemi shpenzuar mjete në vlerë prej **117,430.53 euro**.

Tabela 8. Subvencione dhe transfere

Kategoria e shpenzimit	Shuma e shpenzuar janar - dhjetor 2024
Vizita e studenteve në ZUG- Zvicër	10,000.00 €
Gara në fakultetin e shkencave kompjuterike (dy gara një për studentet e UKZ dhe për nxënësit e shkollave të mesme etj.)	3,789.30 €
Punim shkencore	24,000.00 €
Bursat e studentëve	78,999.56 €
Hulumtuesi i vitit	641.67 €
Totali	117,430.53 €

Në këtë kategori duhet veçuar pagesat e aktivitete të ndryshme përfshirë si: dhënia e bursave për studente, mbështetje e punimeve shkencore për stafin akademik, mbështetje e vizitave studentore jashtë vendit, mbështetja për hulumtuesin e vitit.

Shpenzimet kapitale³

Për vitin 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në kategorinë kapitale ka buxhetin e ndarë në vlerë prej **200,000.00 euro**. Kjo kategori posedon 3 projekte kapitale, si në vijim:

1. Ndërtimi i kampusit të UKZ-së në shumë prej **100,000.00 euro**,
2. Blerja e mobilieve në UKZ në shumë prej **50,000.00 euro** si dhe
3. Blerja e pajisjeve laboratorike dhe të Teknologjisë Informative në shumë prej **50,000.00 euro**.

Në këtë kategori për periudhën raportuese 12 mujore, kemi realizuar shpenzime të buxhetit në vlerë prej **162,724.01 euro**.

Tabela 9. Shpenzimet kapitale

Nr.	Projekti	Shuma	Shpenzimi	Përqindja %
1	Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës në UKZ-së – kod 14039	100,000.00 €	100,000.00 €	100.00 %
2	Blerja e mobileve në UKZ – kod 14047 (Graniti SHPK, Mobile 8,543.00 euro)	50,000.00 €	12,740.00 €	25.48 %
3	Pajisje të IT-së – kod 15256 ⁴ Rikon SHPK, Makina fotokopjuese Multifunksionale, vlera 11,886.00 euro. <i>Sqarim:</i> - Në këtë kategori është bërë edhe furnizimi me Server Room (pajisje të teknologjisë informative si server, router, switch dhe pajisje tjera përcjellëse për kompletim të dhomës së serverëve në shumë prej 26,455.00 Euro - Përmes thesarit sipas aktgjykimeve të formës së prerë nga Gjykata Themelore në Gjiilan janë shlyer detyrimet, respektivisht pagesat për profesorët e pensionuar: <i>Januz Dervodeli</i> 7,038.69 dhe <i>Refik Kryeziu</i> 4,604.32 gjithsejtë në shumë prej rreth 11,600 euro.	50,000.00 €	49,984.01 €	99.97 %
	Totali	200,000.00 €	162,724.01€	81.36%

³ Shih, Aneks Raportin për detajet dhe proceset në prokurim

⁴ Ekzekutimi nga MF-Thesari për pagesën e dy punëtorëve të pensionuar, sipas Vendimeve të përmbauesve Përparim SHPK dhe Besnik Nuhiu.

TË HYRAT NGA DONACIONET (Fondi Burimor 49)

Buxheti i projekteve ndërkombëtare

Universiteti publik “Kadri Zeka” për periudhën raportuese janar-dhjetor 2024, në bazë të projekteve ndërkombëtare ka pasë në dispozicion të hyra buxhetore në shumën prej **257,970.98 €**, nga të cilat ka shpenzuar **184,952.06€**, shprehur në përqindje 71.69 %.

Buxheti sipas listës së projekteve për periudhës raportuese janar – dhjetor 2024, është paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 10. Buxheti dhe shpenzimet e projekteve ndërkombëtare (fondi burimor 49)

Ekronimi – Projektet ndërkombëtare	Buxheti 2024	Shpenzimet 01.01.- 31.12.2024	Mjetet e pashfrytëzuara	Përqindja e shpenzimeve
GREEWEB	55,440.27 €	27,054.00 €	28,386.27 €	48.80 %
SIAHPCD	10,222.82 €	10,085.64 €	137.18 €	98.66 %
STAND	20,121.95 €	11,726.46 €	8,395.49 €	58.28 %
WEBOU	28,836.42 €	28,816.95 €	19.47 €	99.93 %
QATEK	9,672.43 €	9,631.05 €	41.38 €	99.57 %
QUADIC	76,958.68 €	76,958.62 €	0.06 €	100.00 %
SUSWELL	3,225.00 €	3,221.03 €	3.97 €	99.88 %
REACHERCULT	2,148.41 €	2,145.99 €	2.42 €	99.89 %
ENEMLOS	21,170.30 €	15,312.32 €	5,857.98 €	72.33 %
EDUFAIR	30,174.70 €	0.00 €	30,174.70 €	0.00 %
TOTALI	257,970.98 €	184,952.06 €	73,018.92 €	71.69 %

3.1.1. Raporti i prokurimit

Sipas ligjit të prokurimit, zyra e prokurimit është kompetente vetëm për udhëheqjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrimin e kontratës, por jo edhe për përgatitjen e specifikave dhe kërkesave të njësive kërkuuese, pasi që njësitë kërkuuese për ti realizuar propozimet e tyre që i kanë paraparë sipas planit kohor të prokurimit duhet të përgatitin kërkesën se cilin aktivitet dëshirojnë ta iniciojnë dhe se bashku me kërkesë ti bashkëngjisin edhe specifikimet teknike në mënyrë që zyra e prokurimit të bëjë gati dosjen e tenderit.

Raporti vjetor i punës përfshin periudhën prej datës Janar - Dhjetor 2024, ku në mënyrë kronologjike paraqiten punët, aktivitetet e kryera nga Divizioni i Prokurimit në UKZ. Në këtë periudhë janë iniciuar gjithsej **34 procedura të prokurimit** në vlerë prej **911,854.64 €**, dhe vlera e publikimit të njoftimit për kontratë ka ndryshuar varësisht nga lloji procedurës çmimi i procedurës. Sipas strukturës të llojit të procedurës janë zhvilluar 3 aktivitete me procedurë me vlerë të madhe në shumën **575,000.00 €**, 11 aktivitete me procedurë me vlerë të mesme në shumën **316,845.66 €** si dhe 20 aktivitete me procedurë me vlerë të vogël në shumën **19,999.98 €**.

Raportin vjetor të punës për vitin 2024 e karakterizojnë aktivitetet e përmbledhura në tabelën vijuese.

Tabela 11. Numri, lloji dhe çmimi i procedurës

Nr.	Lloji i procedurës	Çmimi i procedurës €	Numri i proced.	Shuma/vlera e procedurës €
1	Procedura me vlerë të madhe	Mbi 125.000 €	3	575,000.00€
2	Procedura me vlerë të mesme	10,000-125.000 €	11	316,845.66€
3	Procedura me vlerë të vogël	1,000 – 10,000 €	0	00.00€
4	Procedura me vlerë të minimale	100 – 1,000 €	20	19,999.98€
	Gjithsej		34	911,845.64€

1. Procedurë me vlerë të madhe, mbi 125,000 €

✚ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit brenda dhe jashtë të Universitetit Publik "Kadri Zeka"** Gjilan, vlera e parashikuar e aktivitetit është 195.000 euro, është lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik “Aroma Plus” SH.P.K nga Prishtina në vlerë prej 161, 549.36 euro për tri (3) vite.

✚ **Furnizim me Licenca të SMU-së – Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU) dhe mirëmbajtja e tij**, vlera e parashikuar e aktivitetit është 230.000.00 euro për 36 muaj.

Kjo kontratë është lidhur me operatorin ekonomik në Procedurë të Negociuar pa Publikim të njoftimit të Kontratës në vlerë prej 158,400.00 euro në çmim mujor prej 4, 400.00 euro për 36 muaj për modulën sipas pozicionit 1 furnizim me licenca të SMU-së;

Ndërsa për pozicione nga dy deri në shtatë (2-7), sipas specifikacionit të dosjes së tenderit pagesa e tyre do të bëhet vetëm me rastin e kërkesës për shfrytëzim nga menaxheri i kontratës;

- Pozicioni 2- Furnizim me licenca për Modulën E-vijueshmërisë çmimi për muaj 160euro;
- Pozicioni 3- Furnizim me licenca për Modulën për Universitetin Veror dhe programet profesionale çmimi për muaj 200 euro;

- Pozicioni 4- Furnizim me licenca për Modulin shkëmbim te studentet çmimi për muaj 200 euro;
- Pozicioni 5 - Furnizim me licenca për Modulin për CV te stafit akademik dhe publikimi i punimeve shkencore çmimi për muaj 300 euro;
- Pozicioni 6- Furnizim me Licenca për Modulin për E-Library çmimi për muaj 300 euro;
- Pozicioni 7- Furnizim me licenca për Aplikacion për telefon çmimi për muaj 100 euro.
- Vlera totale indikative e kontratës është 203 ,760.00 euro.

✚ Renovimi i rektoratit, tualeteve, ndërrimi i trupave ndriçues në hyrjen A dhe B dhe zgjerimi i parkingut- është publikuar në vlerë prej 100,000.00 euro.

- Kjo procedurë është anuluar pasi që kanë ofertuar 3 operator ekonomik dhe asnjëri nuk ka qenë i përgjegjshëm.

✚ Renovimi i rektoratit, tualeteve, ndërrimi i trupave ndriçues në hyrjen A dhe B dhe zgjerimi i parkingut-ritender është publikuar në vlerë prej 150,000.00 euro.

- Këtë aktivitet e kemi ri tenderuar përsëri pasi që aktiviteti i parë është anuluar, sa i përket këtij aktiviteti jemi në fazën e renovimit të objektit, kontrata është lidhur me operatorin ekonomik “Euro Commerce” nga Vitia, në vlerë prej 139,954.79 euro.

✚ Aneks kontrata 10 % e vlerës së përgjithshme të kontratës bazë- Renovimi i rektoratit, tualeteve, ndërrimi i trupave ndriçues në hyrjen A dhe B dhe zgjerimi i parkingut.

✚ Është lidhur kontrata me operatorin ekonomik “Euro Commerce” nga Vitia në vlerë prej 13, 285.60 euro.

Procedurë me vlerë të mesme 10,000 – 125,000 €

Tabela 12. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës së mesme dhe vlera monetare

Nr.	Lloji i procedurës	Çmimi/shuma e procedurës €
1	Furnizim me material dhe pajisje të IT-së	12,158.20 €
2	Furnizim me Kondicioner Ajri për UKZ	28,000.00 €
3	Shërbime për programin softuerik antiplagjiat në UKZ	19,452.50 €
4	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në UKZ – procedurë e negociuar	17,920.00 €
5	Furnizim me printer multifunksional	11,886.00 €
6	Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në UKZ – procedurë e negociuar-Shtator	17,900.00 €
7	Aneks Kontrata- Renovimi UKZ	13, 285.60 €
8	Furnizimi dhe konfigurimi me pajisje teknologjike për server room	26,455.00 €
9	Vazhdim i punimeve-Renovimi-Negocim	22,116.08 €
10	Furnizimi me aparat të vijueshmërisë në punë	33,926.00 €
	Gjithsej	203,099.38€

Nga tabela 2. shihet se janë zhvilluar 10 procedura të prokurimit:

- ✚ **Furnizim me material dhe pajisje të IT-së**, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **12,158.20€** dhe ka përfunduar me sukses.
- ✚ **Furnizim me Kondicioner Ajri për UKZ**, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **19,930.00 euro** dhe ka përfunduar me sukses.
- ✚ **Shërbime për programin softuerik antiplagjiat në UKZ**, është nënshkruar kontrata në vlerë prej **19,452.50 euro** dhe ka përfunduar me sukses.
- ✚ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në UKZ – procedurë e negociuar**, kjo procedurë është e lidhur vetëm për 4 muaj deri në përfundim të procedurave të ankesave pasi që lënda Ka qenë në OSHP, dhe kontrata është lidhur në shumë prej 17,920.00 euro.
- ✚ **Furnizim me printer multifunksional**, është nënshkruar kontrata në vlerë prej 11,886.00 euro dhe ka përfunduar me sukses.
- ✚ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit në UKZ – procedurë e negociuar**, kjo procedurë është e lidhur vetëm për 4 muaj deri në përfundim të procedurave të ankesave pasi që lënda ka qenë OSHP, në shumë prej **17,900.00 euro**, kjo procedurë pas 1 muaji është ndërprerë pasi që është lidhur kontrata me operatorin ekonomik potencial fitues për 36 muaj.

- ✚ **Furnizimi dhe konfigurimi me pajisje teknologjike për server room**, është nënshkruar kontrata në vlerë prej 26,455.00 euro dhe ka përfunduar me sukses
- ✚ **Vazhdim i punimeve – Renovimi në UKZ-** procedurë e Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë- Kontrata është lidhur në shumë prej 22,116.08 euro dhe ka përfunduar me sukses.
- ✚ **Furnizimi, montimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të vijueshmërisë së studentëve, stafit akademik dhe administrativ-** Kontrata është lidhur në shumë prej 33,926.00 euro dhe aktualisht jemi në fazën e furnizimit.

3. Procedurë me vlerë të vogël 1,000 – 10,000 €

Tabela 13. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës së vogël dhe vlera monetare

Nr.	Lloji i procedurës	Çmimi/shuma e procedurës €
1	0	0
	Gjithsej	0

Nga tabela 3. shihet se nuk është zhvilluar asnjë procedurë brenda vitit.

4. Procedurë me vlerë minimale 100.00€ – 1,000.00 €

Tabela 14. Numri i aktiviteteve me procedurë të vlerës minimale dhe vlera monetare

Nr.	Lloji i procedurës	Çmimi/shuma e procedurës €
1	Servisim i veturave zyrtare të UKZ-së	796.00€
2	Furnizim me mbishkrime për zyret në rektoratin e UKZ-së	976.00€
3	Furnizim me material administrative dhe informues për UKZ	991.50€
4	Zyrë projektuese për hartimin e projektit në hyrjen A, renovimi i rektoratit, lysterja e koridoreve dhe toaleteve në UKZ	980.00€
5	Zyrë projektuese për hartimin e projektit në hyrjen B, renovimi i toaleteve, lysterja e koridoreve dhe zgjerimi i parkingut në UKZ	985.00€
6	Furnizimi dhe montrimi me perde në FSHK	548.80€
7	Botimi i librit të abstrakteve për konferencën e tretë vjetore të UKZ 2024	835.50€

8	Furnizim me material për konferencën e tretë vjetore të UKZ 2024	896.20€
9	Furnizim me materiale për mirëmbajtje të objektit të UKZ-së	984.93
10	Furnizim me disqe për kamera	540.00
11	Furnizimi me material për mirëmbajtje të kopshtit të UKZ-së	996.40
12	Servisimi i veturave zyrtare Hyundai Tykson IX35 të UKZ-së	393.00
13	Servisimi i fotokopjeve dhe furnizim me toner	995.00
14	Zyrë për mbikëqyrjen e projektit-Renovimi UKZ	997.00
15	Sigurimi i veturave zyrtare të UKZ-së	998.99
16	Shërbime të transportit për studentët e UKZ-së dhe të PH-Zug	288.00
17	Furnizim me kabëll LAN dhe material shpenzues të TI-së	990.00
18	Shërbime të transportit për stafin ADM të UKZ	699.60
19	Dizajni dhe botimi i buletinit për vitin 2023/2024	990.00
20	Servisimi i dy veturave zyrtare të UKZ-së	997.00
	Gjithsej	16, 878.92 €

Nga tabela 4. shihet se janë zhvilluar gjithsej 20 procedura të cilat kanë përfunduar me sukses në vlerë prej 16,878.92 euro.

Si përfundim, Zyra e Prokurimit për periudhën raportuese Janar - dhjetor 2024 ka nënshkruar kontrata gjithsej në shumë prej **540,146.594€**.

3.2. Personeli (shifrat zhvillimore)

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan ka vazhduar të konsolidojë strukturën e tij të personelit akademik dhe administrativ, në përputhje me objektivat strategjike dhe nevojat e institucionit. Në këtë periudhë janë realizuar procese të rekrutimit, riemërimi dhe avancimi të stafit akademik, si dhe është menaxhuar në mënyrë efikase cikli i punës së stafit administrativ. Zyra e Personelit ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procedurave dhe mbështetjen profesionale të njëjësive organizative të universitetit.

Personeli Akademik

Personeli akademik në UKZ përbëhet nga profesorë dhe asistentë në marrëdhënie të rregullt pune. Aktualisht, numri i stafit të rregullt akademik është *49 persona*, të cilët mbulojnë titujt *Prof. Dr.*, *Prof. Asoc.* dhe *Prof. Ass.*

Gjatë vitit 2024, është zhvilluar një konkurs për *emërimin, riemërimin dhe avancimin* e stafit akademik në njësitë e mëposhtme:

1. Fakulteti i Edukimit:

- 5 pozita gjithsej – 2 emërim të reja, 1 riemërim dhe 2 avancime.

2. Fakulteti Juridik:

- 4 pozita gjithsej – 1 emërim i ri dhe 3 avancime.

3. Fakulteti Ekonomik:

- 7 pozita gjithsej – 1 emërim i ri, 1 riemërim dhe 5 avancime.

4. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike:

- 1 pozitë – emërim i ri.

Personeli administrativ

Në vitin 2024, është realizuar *një procedurë rekrutimi* për staf administrativ, e cila ka përfunduar me sukses. Gjatë të njëjtit vit, *një punonjës administrativ* ka dalë në pension.

Aktualisht, numri i përgjithshëm i nëpunësve të shërbimit publik administrativ në UKZ është **32 persona**, të shpërndarë si vijon:

- 1 drejtues i lartë;
- 1 drejtor;
- 6 në pozita udhëheqëse;
- 11 ushtrues detyre udhëheqës divizioni;
- 12 zyrtarë;
- 1 nëpunës me vendim mandator.

Roli i Divizionit të personelit

Divizioni i personelit ka qenë aktive në funksione të shumta që ndihmojnë në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, duke përfshirë:

- Mbështetje teknike për *komisionet e rekrutimit* dhe zgjidhjen e ankesave;
- *Plotësimin dhe rifreskimin e dosjeve të punonjësve* në sistemin SIMBNJ;
- Administrimin e *pushimeve vjetore dhe lejeve të tjera* për stafin;
- *Menaxhimin e kontratave të punës* dhe zbatimin korrekt të procedurave të rekrutimit;
- Këshillim dhe mbështetje për udhëheqësit e njësisve në lidhje me *përshkrimet e vendeve të punës, vlerësimin e performancës dhe zhvillimin profesional* të stafit.

Zhvillimi profesional dhe trajnime

Plani i personelit për vitin 2024 është regjistruar në sistemin SIMBNJ, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në trajnime të organizuara nga:

- *Instituti për Administratë Publike (IKAP),*
 - *Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),*
 - *Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit,*
- dhe fusha të tjera relevante, përfshirë trajnime për sinjalizim dhe etikë në administratë.*

Tabela 15. Personeli akademik

Emri dhe mbiemri		Konkursi I		Konkursi II		Konkursi III		Konkursi IV	Fusha e studimit	
Nr.		Prej	Deri	Prej	Deri	Prej	Deri			
1	Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku					01.05. 2018	30.04. 2022	01.10. 2023	30.09. 2027	Shkenca kompjuterike (algoritmet euristike në mekatronikë dhe robotikë aspektet softuerike)
2	Prof. Asoc. Dr. Shpresë Qamili	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedura e rizgjedhjes është shtyrë për 1 vit (2019)		01.10. 2019	30.09. 2023	15.02. 2022	14.02. 2026	Gjuhë angleze (didaktikë)
3	Prof. Dr. Xhevdet Thaqi	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedura e rizgjedhjes është shtyrë për 1 vit (2019)		01.10. 2019	30.09. 2023	15.02. 2022	E përherëshme	Matematikë (didaktikë për shkencat eksperimentale)
4	Prof. Asoc Dr. Gëzim Tosuni	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedura e rizgjedhjes është shtyrë për 1 vit (2019)		01.10. 2019	30.09. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Ekonomi (makroekonomi)
5	Prof. Asoc. Dr. Arben Mustafa	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedura e rizgjedhjes është shtyrë për 1 vit (2019)		01.10. 2019	30.09. 2023	15.02. 2022	14.02. 2026	Ekonomi (makroekonomi)
6	Prof. Dr. Sadik Haxhiu	01.10. 2014	30.09. 2018	26.03.2019	26.03. 2019	01.04. 2019	31.03. 2023	12.06. 2023	E përherëshme	Juridik (kushtetuese)

7	Prof. Asoc. Dr. Lutfi Zharku	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedura e rizgjedhjes është shtyrë për 1 vit (2020)		01.10. 2019	30.090 .2023	15.02. 2022	14.02. 2026	Ekonomi (financa)
8	Prof. Asoc..Dr. Teuta Agaj	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Filologji (gjuhe angleze)
9	Prof. Ass. Dr. Mensur Neziri	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Pedagogji (kurrikula)
10	Prof. Ass. Dr. Afërdita Ibrahim	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021		30.09. 2022	27.12. 2023	26.12. 2027	Sh. kompjuterike
11	Prof. Asoc. Dr. Fatmire Krasniqi	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021	27.12. 2024	26.12. 2028			Juridik (penale)
12	Prof. Ass. Dr. Arbenita Kosumi	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021		30.09. 2022	01.10. 2022	30.09. 2026	Ekonomi (banka financa)
13	Prof. Ass. Dr. Detrina Alishani	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021		30.09. 2022	01.10. 2022	30.09. 2026	Juridike (civile)
14	Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Juridik (kushtetuese)
15	Prof. Asoc. Dr Arben Sahiti	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021	24.02. 2025	23.02. 2029			Ekonomi (financa)
16	Prof. Ass. Dr. Lulzim Rashiti	01.10. 2014	30.09. 2017	01.10.2018	30.09. 2021		30.09. 2022	01.10. 2022	30.09. 2026	Ekonomi (marketing)
17	Prof. Dr. Naim Mustafa			15.02.2016	14.02. 2020	01.10. 2020	27.12. 2024	E përher shme		Ekonomi (menaxhment)
18	Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti			15.02.2016	14.02. 2020	01.10. 2020	24.02. 2025	23.02. 2029		Matematikë - statistikë (gjeometri diferenciale- rihman)
19	Prof. Dr. Dukagjin Leka			15.02.2016	14.02. 2020	01.10. 2020	27.12. 2024	E përher shme		Juridik (ndërkombëtare)

20	Prof. Asoc. Dr. Nevrije Ismajli	15.02.2016	14.02. 2020	01.10. 2020	27.12. 2024	26.12. 2028	Filologji (letërsi)		
21	Prof. Dr. Merxhan Avdyli	15.02.2016	14.02. 2020	01.10. 2020	27.12. 2024	E përher shme	Filologji (letërsi)		
22	Prof. Asoc. Dr. Basri Ahmedi	15.02.2016	14.02. 2020	20.10. 2020	30.09. 2024	15.02. 2022	14.02. 2026	Shkenca kompjuterike (rrjeta kompjuterike)	
23	Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa	15.02.2016	14.02. 2020	20.10. 2020	30.09. 2024	15.02. 2022	14.02. 2026	Shkenca kompjuterike (Sistemi i kontrollit dhe Teknologjisë)	
24	Prof. Asoc. Dr. . Lindita Hyseni,	15.02.2016	14.02. 2019	01.10. 2019	26.09. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Shkenca kompjuterike (sistemet e informacionit)	
25	Prof. Dr. Ekrem Halimi	15.02.2016	14.02. 2020	20.10. 2020	16.01. 2025	E perher shme	Matematike (analizë dhe algjebër)		
26	Prof. Asoc. Dr. Urtak Hamiti			15.02. 2017	14.02. 2021	01.04. 2024	30.03. 2025	Juridik (ndërkombëtare)	
27	Prof. Dr. Xhevat Sopi			05.12. 2016	04.12. 2020	24.02. 2025	E perhe rshme	Ekonomi (menaxhment)	
28	Prof. Dr. Bashkim Dalipi			15.02. 2017	14.02. 2021	24.02. 2025	E përhe rshme	Shkenca natyrore (fizikë)	
29	Prof. Asoc. Dr. Selim Daku			01.10. 2020	30.09. 2024	27.12. 2024	26.12. 2028	Juridik (ndërkombëtare)	
30	Prof. Asoc. Dr. Nexhat Shkodra			15.02. 2021	14.02. 2025	24.02. 2025	23.02. 2029	Ekonomi (makroekonomi)	
31	Prof. Asoc. Dr. Voglushe Kurteshi			26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Pedagogji	
32	Prof. Ass. Dr. Bajram Fejzullahu			26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Ekonomi (Menaxhment dhe Ndermarrësi)	

33	Prof. Asoc. Dr. Kastriot Dërmaku	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Shkenca Kompjuterike (Teknologji Informatike)		
34	Prof. Asoc. Dr. Albulena Hajdari- Krasniqi	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Juridik (Shkenca Juridike)		
35	Prof. Asoc. Dr. Fadil Osmani	26.08. 2019	26.08. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Juridik (Shkenca Juridike)		
36	Prof. Ass. Dr. Arbona Xhemajli	01.10. 2021	30.09. 2025			Pedagogji		
37	Prof. Asoc. Dr. Art Shala	15.02. 2021	14.02. 2025	24.02. 2025	23.02. 2029	Ekonomi		
38	Prof. Ass.Dr. Valbona Zeqiraj	01.10. 2021	30.09. 2025			Ekonomi, Banka dhe Financa		
39	Prof. Ass. Dr. Ardian Emini	01.10. 2020	30.09. 2025			Histori		
40	Prof. Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi	01.10. 2019	30.09. 2023	27.12. 2023	26.12. 2027	Psikologji-Pedagogji		
41	Prof. Ass. Dr. Drita Kryeziu Musmurati	31.03. 2022	30.09. 2022	01.10. 2022	30.09. 2026	Shkenca Pedagogji	Sociale,	Psikologji-
42	Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu Kryeziu	01.10. 2022	30.09. 2026			Pedagogji		
43	Prof. Ass. Dr. Flamur Maloku	01.10. 2022	30.09. 2026			Letërsi dhe Gjuhë Shqipe		
44	Prof. Ass. Dr. Sylë Ukshini	14.11. 2022	30.09. 2026			Histori Ndërkombëtare	dhe	Marrëdhënie
45	Prof. Ass. Dr. Vaxhid Sadriu	10.10. 2024	09.10. 2028			Juridik (Penal)		

46	Prof. Ass. Dr.S hejnaze Gagic	10.10. 2024	09.10. 2028						Komunikimet Sociale dhe Shkenca e Informacionit
47	Prof. Ass. Dr. Fitore Malaj Abdyl	22.10. 2024	21.10. 2028						Edukim (Pedagogji)
48	Prof. Ass. Dr. Lindita Loku-Nikçi	22.10. 2024	21.10. 2028						E-teknologji
49	Prof. Asoc. Dr. Fejzullah Hasani	01.10. 2014	30.09. 2018	Procedurë e rizgjedhjes është shtyrë për një vit (2019)	01.10. 2019	30.09. 2023	15.02. 2022	14.02. 2026	Juridik Penal

Tabela 16. Numri i stafit akademik dhe administrativ sipas gjinisë

Fakulteti /Programi i studimit	Të rregullt		Të angazhuar		Staf tjetër (administrativ)	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Fakulteti i Edukimit	8	6	12	11		
Fakulteti Ekonomik	3	11	5	7		
Fakulteti Juridik	4	9	4	8		
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	3	5	6	8		
Fakulteti i Shkencave Sociale			3	1		
Administrata qendrore - Rektorati	0	0	0	0	19	13
Gjithsej meshkuj/femra	18	31	30	35	19	13
Gjithsejtë numri i stafit akademik	49		65		32	

Numri total i stafit akademik dhe administrativ të rregullt dhe të angazhuar është si në tabelën në vijim.

Tabela 17. Staf i akademik dhe administrativ

Profesorë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	49
Asistentë në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	0
Ligjërues në marrëdhënie të rregullt pune në UKZ	0
Profesorë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	18
Ligjërues të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	1
Asistentë të angazhuar (bashkëpunëtorë të jashtëm)	46
Administratë	32
Gjithsej	146

3.3. Infrastruktura

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka ndërmarrë një sërë iniciativash të rëndësishme në funksion të përmirësimit të infrastrukturës fizike dhe ambientit akademik, me synim sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e një procesi mësimor bashkëkohor dhe cilësor. Këto iniciativa janë fokusuar si në mirëmbajtjen dhe modernizimin e hapësirave ekzistuese, ashtu edhe në avancimin e projekteve të reja për ndërtimin e kampusit universitar, përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet qendrore dhe ato lokale. Investimet në infrastrukturë janë parë si bazë themelore për krijimin e një mjedisi stimulues për mësim, kërkim shkencor dhe zhvillim profesional për studentët dhe stafin e universitetit.

Gjendja aktuale e infrastrukturës

Infrastruktura ekzistuese e UKZ-së i përmbush kushtet minimale për zhvillimin e ligjëratave dhe ofrimin e shërbimeve administrative. Sallat e mësimi janë të pajisura me projektorë, zyrat janë të furnizuara me inventarin përkatës dhe e gjithë hapësira është e mbuluar me internet falë projektit *KODE–KREN*, në bashkëpunim me *Bashkimin Evropian dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik*.

- *Objekti kryesor* përfshin një sipërfaqe prej 6,900 m², ku përfshihen sallat e mësimi, zyrat, laboratorët, kabinetet, biblioteka dhe hapësira të tjera të nevojshme.
- *Kampusi i UKZ-së* në total shtrihet në një sipërfaqe prej 2 hektarësh (20,000 m²).

Në kuadër të politikave zhvillimore për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe ambientit akademik, gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka miratuar dokumentin **“Strategjia e Zgjerimit dhe Rikonstruktimit të Hapësirave Ekzistuese 2025–2027”**.

Strategjia është rezultat i një analize të detajuar të sfidave aktuale me të cilat përballlet institucioni, veçanërisht në lidhje me mungesën e hapësirave adekuate për mësimdhënie, punë kërkimore dhe shërbime administrative. Si rrjedhojë, drejtimi strategjik i zhvillimit infrastrukturor të UKZ-së është përqendruar në dy shtylla kryesore:

1. **Ndërtimi i hapësirave të reja**, që përfshin ndërtimin e një kampusi modern universitar me standarde bashkëkohore për të gjitha njësitë akademike dhe administrative;
2. **Rimodelimi dhe rikonstruktimi i hapësirave ekzistuese**, me synim optimizimin e përdorimit të tyre dhe krijimin e kushteve më të mira për mësim, punë dhe shërbime studentore.

Të dy drejtimet mund të zhvillohen paralelisht, por paraprakisht është e nevojshme **hartimi i një studimi të fizibilitetit (feasibility study) dhe një master-plani të detajuar**, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për planifikimin, buxhetimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme. Ky plan duhet të përfshijë burimet potenciale të financimit, partnerët institucionalë dhe hapat konkretë për realizimin e projekteve.

Sipas vlerësimeve paraprake, një investim i tillë – nëse sigurohet në fillim të vitit 2025 – kërkon një periudhë zbatimi prej së paku **3 deri në 4 vjet**, përderisa të gjitha fazat zhvillohen pa pengesa të natyrës financiare apo procedurale. Megjithatë, përvoja në projekte publike tregon se **procedurat burokratike** dhe **mungesa e burimeve/resurseve financiare** shpesh mund të shkaktojnë vonesa, ndaj është thelbësore koordinimi i ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale për zbatimin efikas të kësaj strategjie.

Bashkëpunimi me BEI dhe MASHTI për ndërtimin e kampusit të ri

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme të vitit 2024 ka qenë pjesëmarrja në projektin e financuar nga [Banka Evropiane për Investime \(BEI\)](#), [“Vlerësimi i fizibilitetit dhe nevojave për institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë”](#), i implementuar nga konsorciumi SOFRECO. Ky projekt, në bashkëpunim me MASHTI-n, synon përmirësimin e infrastrukturës së arsimit të lartë në vend. Si rezultat i vlerësimeve të ekspertëve, është rekomanduar ndërtimi urgjent i një *kampusi të ri për UKZ-në*, i cili është përfshirë në projektet e *Western Balkans Investment Framework (WBIF)/ Fondet për Investimet në Zhvillimin e Ballkanit Perëndimor*) dhe është miratuar si projekt strategjik nga *Qeveria e Kosovës*.

Menaxhmenti i universitetit ka zhvilluar takime intensive me *Komunën e Gjilanit*, si dhe ka dorëzuar *tri kërkesa zyrtare* në lidhje me këtë projekt (në datat 30 tetor dhe 3 dhjetor 2024). Pritet që në fillim të vitit 2025 të përfundojnë procedurat administrative dhe të nisë faza e zbatimit.

Përmirësime të realizuara në infrastrukturën ekzistuese gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 janë realizuar disa investime konkrete në përmirësimin e hapësirave dhe pajisjeve teknologjike, si më poshtë:

1. [Renovimi i objektit të rektoratit](#)

- Aktiviteti përfshinte: përmirësimin e tualeteve, ndërrimin e ndriçuesve në hyrjet A dhe B, si dhe zgjerimin e parkingut.
- Pas anulimit të tenderit të parë, është lidhur kontrata me OE “*Euro Commerce*” – Viti në vlerë 139,954.79 €, dhe një aneks kontratë në vlerë 13,285.60 €.
- Për pjesën e mbetur është realizuar një kontratë e re në vlerë 22,116.08 €, përmes procedurës së negociuar pa publikim, dhe punimet janë përfunduar me sukses.

2. Furnizim dhe mirëmbajtje e Sistemit të Menaxhimit Universitar (SMU)

- Kontratë në vlerë 158,400.00 € për 36 muaj, me pagesë mujore prej 4,400.00 €.

3. Pajisje dhe shërbime të tjera të realizuara me sukses:

- Furnizim me pajisje IT – 12,158.20 €
- Furnizim me kondicioner ajri – 19,930.00 €

- Shërbim për softuerin antiplagjiaturë – 19,452.50 €
- Furnizim me printer multifunksional – 11,886.00 €
- Pajisje për server room (furnizim dhe konfigurim) – 26,455.00 €

5. Pajisje për vijueshmëri të studentëve dhe stafit – 33,926.00 € (në fazën e furnizimit)

Viti 2024 shënoi një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të infrastrukturës së Universitetit Publik “Kadri Zeka”, si në aspektin e përmirësimeve të brendshme, ashtu edhe në përgatitjen për ndërtimin e një kampusi të ri. Këto zhvillime janë dëshmi e përkushtimit institucional për të garantuar një mjedis bashkëkohor për mësim, kërkim dhe zhvillim profesional.

Në tabelat vijuese paraqitet gjendja aktuale i infrastrukturës së objektit, ku përfshihen sallat e mësimi, zyrat, laboratorët, kabinetet, biblioteka dhe hapësira të tjera të nevojshme si dhe pajisjeve të IT-së.

Tabela 18. Zyrat e KD, menaxhmentit, dekanëve, stafit akademik, stafit administrativ, parlamentit studentor dhe depos

Zyrat	Nr. i zyrave	Hyrja A	Hyrja B
Zyra e Këshillit Drejtues	1	Kati I	
Zyrat e Menaxhmentit	5	Kati I - Rektorat	
Zyrat e dekanëve	5	Kati I, II	Kati P,I,II
Zyrat e Stafit akademik	19	Kati I, II,III	Kati P, I, II
Zyrat e Stafit administrativ	19	Kati P, I, II	Kati P, I,
Zyra e Parlamentit Studentor	1		Kati II
Depo	3	Kati nëntokësor- P	

Tabela 19. Sallat e mësimi, kabinetet e informatikës dhe laboratorët

Hyrja A		Hyrja B	
Salla Nr.	Nr. i ulëseve	Salla Nr.	Nr. i ulëseve
A/01	72	Amfiteatër i vogël (B/01)	94
A/02	92	B/02	78
A12	67	B/03	40
Klasa e dedikuar për parashkollor (A/14)	32	Salla e Informatikës/ Laborator i rrjeteve kompjuterike (B/10)	15
A/21	41	B/11	107
A/22	80	Salla e Informatikës (B/12)	30

A/23	37	B/21	113
A/25	54	B/22	49
A/33	30	B/23	25
Laboratori i Shkencave Natyrore (A/13)	47	Salla e Informatikës/ Laboratori i rrjeteve kompjuterike (B/24)	31
Salla e Arteve (A/26)	30	Salla e Informatikës B/31	27
Kabineti i Muzikës (A/24)	56		
Salla e Konferencave (A/34)	70		
Salla e Leximit	250		
Salla mësimi A27	57		
Salla mësimi	30		
Gjithsej	1045	Gjithsej	609

Hapësira dhe aparatura

Në hapësirat e UKZ-së ekziston hapësirë minimalisht e mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Pas investimeve të bëra gjatë vitit 2020 dhe të 2021 janë përfituar hapësirë shtesë punuese në sipërfaqe rreth 500 m².

Struktura e hapësirave për ligjërata është e shpërndarë në dy hyrjet e objektit të UKZ-së: A dhe B. Kjo shpërndarje është paraqitur në pikën 1.2.3 (Infrastruktura, faqe 25) në tabelën 19.

Hapësirat e UKZ-së për organizimin e procesit mësimor janë për 1045 studentë në hyrjen A dhe 609 në hyrjen B, apo gjithsej për 1654 studentë në të njëjtën kohë. Ky numër sipas nevojës mund të rritet për të njëjtën kohë deri në 1800 studentë.

Tabela 20. Pajisjet

Nr.	Pajisjet	Njësia
1	Projektorë	19
2	Grafoskopë	3
3	Pajisje laboratorike	5
4	Smart bord me projektor	7
5	Smart TV	7

Tabela 21. Pajisjet

Lista e pajisjeve në UKZ		
Nr.	Emërtimi i Pajisjeve	Njësia / Copë
1	Kompjuterë në laboratorë të Informatikës	125
2	Kompjuter për stafin akademik	75
3	Kompjuterë për administratë	43
4	Laptop	62
5	Laptop për studentë në laborator	15
6	Projektorë	19
7	Fotokopje	19
8	Printer	70
9	Printer për ID-kartela	1
10	Lexues Optik	1
11	WI-FI (modem)	15
12	Server	2
13	Pajisje laboratorike	15
14	Grafoskop	13
15	Kamerat e sigurie	38
16	Aparat Profesional Fotografik	4
17	Tabela Elektronike (E mençur)	4
18	Router	6
19	Swich te menaxhueshem	10
20	Switch të thjeshtë	15
21	UPS	50
22	Scanner	4
23	Access Point	40

UKZ-ja ka përfituar edhe pajisje më bashkëkohore (laptopë, smartboard, projektor me motor, TV, sistemi digjital për Konferenca Ndërkombëtare live me mikrofona dhe kamera e TV, Kompjuterë All in one).

Tabela 22. Numri i kompjuterëve (desktopë dhe laptopë) funksionalë që disponon Universiteti

	Përdoren nga stafi akademik	Përdoren nga stafi administrativ	Përdoren nga studentët	Gjithsej kompjuterë
Numri i përgjithshëm i kompjuterëve	233	68	125	426

Përveç pajisjeve të listuara më lartë, Universiteti ka përfituar grante nga projektet e ndryshme, si: SMAHPC dhe QATEK përmes të cilave grante ka pasuruar fondin e pajisjeve të ndryshme që i lehtëson aktivitetet akademike.

Tabela 23. Pajisje të mundësuar nga grante dhe projekte të ndryshme

Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Lloji i pajisjes	Numri total i pajisjeve
Laptop	74
Kompjuter ALL IN ONE	25
Video Projektor	15
Mobile Projektor	4
Aparat Profesional	1
Printer Multifunksional	3
Kamera Ultra HD	2
Kompjuter Desktop	15
Video Conference Sound System – Online learning equipment	2

Biblioteka e Universitetit është pasuruar me tituj të rinj si çdo vit edhe gjatë vitit 2023 si:
 Instituti i Historisë – Prishtinë, 41 ekz.,
 Projekti SMAHPC, 133 ekz.,
 Universiteti i Tetovës, 13 ekz., UKZ-10 ekz.,
 dhe donatorë të ndryshëm që kanë dhuruar dhe pasuruan bibliotekën tonë me tituj të rinj.
 Gjithsej gjatë vitit 2024 në bibliotekë kam pranuar 266 ekzemplarë të rinj.

3.4. Profili akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.)

Në vitin 2024 janë [hapur konkurse për avancimin e stafit akademik](#) përkatësisht të një pjese që kanë fituar të drejtën për të konkurruar për avancime. Në këtë konkurs kanë aplikuar kandidat ku kanë plotësuar kushte për avancim nga Prof. Ass në Prof. Asoc. dhe nga Prof. Asoc. në Prof. Dr. dhe katër janë emëruar për herë të parë në marrëdhënie të rregullt pune me titullin Prof. Ass.

Ne vitin 2024 janë pranuar katër (4) profesorë të rinj, prej të cilëve:

- 1 është nga profili i fushës së pedagogjisë
- 1 është nga profili i fushës së shkencave sociale
- 1 është nga profili i fushës së shkencave kompjuterike
- 1 është nga profili i fushës së shkencave juridike

3.5. Programet e studimit

Në kuadër të përmbushjes së misionit të saj akademik dhe në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ofron një gamë të gjerë programesh studimore të akredituara. Këto programe janë të strukturuar sipas sistemit të tri cikleve dhe të harmonizuara me kërkesat e Procesit të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS).

UKZ ka [gjashtë \(6\) njësi akademike/fakultete](#) dhe një (1) njësi organizative ([Biblioteka Universitare](#)). Aktualisht në këto fakultete ofrohen katërmëdhjetë (14) programe studimore: nëntë (9) programe të nivelit Bachelor (BA dhe BSc) dhe pesë (5) programe të nivelit Master (MA dhe MSc).

Në vijim paraqitet struktura e përgjithshme e programeve studimore sipas njësive akademike të UKZ-së.

Tabela 24. Programet e studimit

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Niveli i studimit	Grada që fitohet
1.	Fakulteti i Edukimit	Parashkollor	BA	Bachelor i arsimit parashkollor
		Fillor	BA	Bachelor i arsimit fillor
		Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	MA	Master i mësimdhënies në gjuhë dhe letërsi shqipe
		Mësimdhënie e Kurrikula	MA	Master në mësimdhënie dhe kurrikula
2.	Fakulteti Juridik	Juridik i përgjithshëm	LLB	Jurist i diplomuar
		Juridiko penal	LLM	Master në juridiko penal
3.	Fakulteti Ekonomik	Menaxhment dhe Ndërmarrësi	BSc	Bachelor në menaxhmentit dhe ndërmarrësi
		Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	BSc	Bachelor në Financë dhe Kontabilitet të Aplikuar
		Marketing dhe Menaxhim i Shitjes	BSc	Bachelor në Marketing dhe Menaxhim i Shitjes
4.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	Shkencat kompjuterike	BSc	Bachelor i shkencave kompjuterike
		E-qeverisja	MSc	Master i E-qeverisjes
		Sistemet e kontrollit dhe Inteligjenca artificiale	MSc	Master i Sistemeve të kontrollit dhe inteligjencës artificiale
5.	Fakulteti i Shkencave Aplikative	Matematikë Arsimore	BA	Bachelor i Matematikës Arsimore
6.	Fakulteti i Shkencave Sociale	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane	BA	Bachelor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve Evropiane

Në [Fakultetin e Edukimit](#) në nivelin bachelor programi i studimit Arsimit Fillor (BA), nuk është akredituar nga AKA, por studimet vazhdojnë të organizohen për studentët e vitit të dytë, tretë dhe të katërt, të cilët janë të regjistruar në vitet paraprake.

Në [Fakultetin e Juridik](#) në nivelin master programi i studimit Juridiko-Penal (LLM), nuk është akredituar nga AKA, por studimet vazhdojnë të organizohen për studentët e vitit të parë, të cilët janë të regjistruar në vitin paraprak.

Në [Fakultetin Ekonomik](#) në nivelin baçelor programi i studimit Menaxhment dhe Ndërmarrësi (BSc), nuk është akredituar nga AKA, por studimet vazhdojnë të organizohen për studentët e vitit të dytë dhe të tretë, të cilët janë të regjistruar në vitet paraprake.

Në [Fakultetin e Shkencave të Aplikuara](#) në nivelin baçelor programi i studimit Matematikë Arsimore (BSc), nuk është akredituar nga AKA, por studimet vazhdojnë të organizohen për studentët e vitit të tretë, të cilët janë të regjistruar në vitet paraprake.

Në vitin 2024, është aplikuar në AKA për akreditimin e programeve të reja studimore dhe ri-akreditimin e atyre ekzistuese.

Ndryshueshmëria e zhvillimit të programeve në UKZ është përcjellë me rritje të fushave të studimit në UKZ. Një zhvillim të programeve studimore mund të shihet në tabelën në vazhdim.

Tabela 25. Riakreditim të programeve studimore

Fakulteti	Programi	Akredituar/Riakredituar	Akreditimi aktual
Edukimi	Arsimi Parashkollor	01.10.2014 - 30.09.2016 01.10.2016 - 30.09.2020 01.10.2020 - 30.09.2021 01.10.2021 - 30.09.2024	01.10.2024 - 30.09.2027
Ekonomik	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuara	01.10.2014 - 30.09.2017 01.10.2017 - 30.09.2020 01.10.2020 - 30.09.2024	01.09.2024 - 30.09.2027
	Marketing dhe Menaxhim i Shitjes		01.10.2024 - 30.09.2027
Juridik	Juridik i Përgjithshëm	01.10.2014 - 30.09.2016 01.10.2016 - 30.09.2019 01.10.2019 - 30.09.2020 01.10.2020 - 30.09.2025	Në proces
Shkenca Kompjuterike	Shkencat Kompjuterike	01.10.2014 - 30.09.2016 01.10.2016 - 30.09.2019 01.10.2019 - 30.09.2021	01.10.2021 - 30.09.2026
Fakulteti i Shkencave Sociale	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane		01.10.2024 - 30.09.2027

Fakulteti i Edukimit (Master)	Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe	01.10. 2021 - 30.09.2024	01.10.2024 - 30.09.2027
	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	01.10. 2021 - 30.09.2024	01.10.2024 - 30.09.2027
	Mësimdhënie në Gjuhë Angleze		Në Proces
Fakulteti Ekonomik (Master)	Analiza Ekonomike dhe Politika e Zhvillimit		Në proces
Fakulteti Juridik	Juridiko Penal	01.10. 2021 -30.09.2024	Në proces
Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (Master)	E – Qeverisja	01.10.2017 - 30.09.2021 01.10.2021 - 30.09.2024	01.10.2024 - 30.09.2027
	Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale	01.10. 2021 - 30.09.2024	01.10.2024 - 30.09.2027

Ndërsa si programe të reja, UKZ ka aplikuar në këto programe:

3. [Analiza ekonomike dhe politika zhvillimore](#) – Master
4. [Mësimdhënie në gjuhën angleze](#) – Master

UKZ është akredituar katër herë që nga themelimi i tij: akredituar në vitin 2014, ri-akredituar në vitin 2017, ri-akredituar përsëri në vitin 2020, dhe së fundmi ri-akredituar në vitin 2023.

Tabela 26. Akreditimi institucional

Akreditimi institucional	Akredituar/ Riakredituar	Akreditimi Aktual
Universiteti Publik "Kadri Zeka"	01.10.2014 - 30.09.2017	01.10.2024 - 30.09.2029
	01.10.2017 - 30.09.2021	
	01.10.2021 - 30.09.2024	

3.6. Numri i studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit)

Gjatë vitit 2024, Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka organizuar *dy konkurse për pranimin e studentëve të rinj*, të mbajtura në muajt *korrik dhe shtator*. Këto konkurse janë realizuar në përputhje me planifikimet akademike dhe kapacitetet e njësive përkatëse.

Tabela e mëposhtme përmbledh të dhënat statistikore për studentët e regjistruar për herë të parë, studentët aktivë, të diplomuarit, studentët e transferuar dhe ata të çregjistruar gjatë periudhave përkatëse.

Përmbledhje e të dhënave kryesore:

- **Studentët e pranuar për herë të parë** në vitin akademik **2024/2025** janë gjithsej **579**, prej tyre **480** në nivelin **baçelor** dhe **99** në **master**. Kjo tregon një interes të qëndrueshëm për programet studimore të UKZ-së, veçanërisht në ciklin e parë të studimeve.
- Numri i **studentëve aktivë** në vitin akademik **2024/2025** është gjithsej **1,582** (baçelor: 1,353; master: 229), që pasqyron vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e procesit mësimor.
- Në total, nga fillimi i funksionimit të universitetit (2013/2014) deri në vitin akademik **2024/2025**, janë pranuar gjithsej **11,579 studentë** (baçelor: 10,773; master: 806), që reflekton rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve dhe besimin e studentëve në institucion.
- **Të diplomuarit** në vitin akademik **2023/2024** janë gjithsej **260 studentë**, prej tyre **192** nga niveli **baçelor** dhe **68** nga niveli **master**.
- Në të gjitha vitet akademike nga **2016/2017** deri në **2023/2024**, UKZ ka diplomuar gjithsej **2,462 studentë** (bachelor: 2,295; master: 167), duke konfirmuar përkushtimin e institucionit për ofrimin e arsimit cilësor dhe përmbylljen me sukses të cikleve studimore.
- Sa i përket **mobilitetit të studentëve**, gjatë **pesë viteve të fundit** (2020/2021 – 2024/2025), në UKZ janë transferuar gjithsej **33 studentë** nga institucione të tjera të arsimit të lartë (të gjithë në nivelin **baçelor**), duke dëshmuar fleksibilitetin dhe tërheqjen e UKZ-së si destinacion arsimor.
- Në vitin akademik **2023/2024**, janë çregjistruar gjithsej **226 studentë** (baçelor: 220; master: 6), ndërsa **në të gjitha vitet akademike** (2013/2014 – 2023/2024), janë çregjistruar gjithsej **2,187 studentë** (bachelor: 2,160; master: 27). Ky tregues flet për dinamikat dhe sfidat që hasin studentët gjatë rrugëtimit të tyre akademik.

Të dhënat e paraqitura dëshmojnë një **rritje të qëndrueshme të regjistrimeve, një normë të mirë diplomimi**, si dhe një **përqindje të menaxhueshme të çregjistrimeve**, duke e pozicionuar Universitetin Publik “Kadri Zeka” si një institucion të konsoliduar në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Përkushtimi për ofrimin e kushteve të favorshme akademike dhe administrative për studentët vazhdon të jetë në qendër të veprimtarisë institucionale.

Tabela 27. Te dhënat e përgjithshme për studentet e pranuar, aktual, të transferuar, te diplomuar dhe te çregjistruar

	Studentet e pranuar për here të pare 2024/2025	Student aktiv ne vitin akademik 2024/2025	Studentet e pranuar për here të pare ne të gjitha vitet akademike (2013/2014 – 2024/2025)	Student të transferuar nga IAL tjera ne UKZ ne 5 vitet e fundit (2020/2021- 2024/2025)	Studentet e diplomuar ne vitin akademik 2023/2024	Studentet e diplomuar ne të gjitha vitet akademike (2016/2017 – 2023/2024)	Student te çregjistruar ne vitin akademik 2023/2024	Student te çregjistruar ne të gjitha vitet akademik (2013/2014 - 2023/2024)
Bachelor	480	1353	10773	33	192	2295	220	2160
Master	99	229	806	0	68	167	6	27
Gjithsej	579	1582	11579	33	260	2462	226	2187

Tabela 28. Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2024/2025. Niveli Bachelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	2024-2025
1	Bachelor	Edukim	Arsimi Fillor	0
2	Bachelor	Edukim	Arsimi Parashkollor	35
3	Bachelor	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	124
4	Bachelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	0
5	Bachelor	Ekonomik	Menaxhment dhe informatikë	0
6	Bachelor	Ekonomik	Marketing	0
7	Bachelor	Ekonomik	Menaxhment	0
8	Bachelor	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	0
9	Bachelor	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	72
10	Bachelor	Ekonomik	Marketing dhe Menaxhimi i Shitjes	68
11	Bachelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike	150
12	Bachelor	Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	0
13	Bachelor	Shkenca Sociale	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane	31
			Gjithsej	480

Tabela 29. Numri i studentëve të pranuar në vitin akademik 2024/2025 Niveli Master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	2024-2025
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	17
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	30
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0
4	Master	Juridik	Juridik Penal	0
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale	23
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	29
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0
			Gjithsej	99

Tabela 30. Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	13-14	14-15	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	24-25	Gjithsej
1	BA	Edukim	Arsimi Fillor	253	134	189	154	131	125	107	120	51	40	35	0	1339
2	BA	Edukim	Arsimi Parashkollor	205	103	116	82	85	79	67	80	38	30	30	35	950
3	BA	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	529	444	348	314	282	247	219	179	154	89	109	124	3038
4	BA	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	312	328	251	196	94	86	124	154	0	0	0	0	1545
5	BA	Ekonomik	Menaxhment dhe informatike	282	270	223	0	0	0	0	0	0	0	0	0	775
6	BA	Ekonomik	Marketing	155	156	112	89	72	85	0	0	0	0	0	0	669
7	BA	Ekonomik	Menaxhment	0	0	0	148	105	109	127	0	0	0	0	0	489
8	BA	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	0	0	0	0	0	0	0	86	69	68	0	0	223
9	BA	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	71	60	95	72	298
10	BA	Ekonomik	Marketing dhe Menaxhimi i Shitjes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	68	68

11	BA	FSHK	Shkenca Kompjuterike	0	123	108	134	112	81	64	76	128	148	143	150	1267
12	BA	FSHA	Matematikë Arsimore	0	0	0	0	0	0	22	36	23	0	0	0	81
13	BA	FSHC	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	31	31
			Gjithsej	1736	1558	1347	1117	881	812	730	731	534	435	412	480	10773

Tabela 31 Numri i studentëve të pranuar në të gjitha vitet akademike - niveli master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	13-14	14-15	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	24-25	Gjithsej
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	0	0	0	0	0	0	0	0	30	30	29	17	106
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	0	0	0	0	0	0	0	0	30	30	30	30	120
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0	0	0	0	51	29	22	34	0	0	0	0	136
4	Master	Juridik	Juridik Penal	0	0	0	0	0	0	0	0	20	25	24	0	69
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale	0	0	0	0	0	0	0	0	23	6	7	23	59
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	0	0	0	0	0	0	0	0	40	37	19	29	125
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0	0	0	0	61	47	37	46	0	0	0	0	191
			Gjithsej	0	0	0	0	112	76	59	80	143	128	109	99	806

Tabela 32. Numri i studentëve të transferuar - niveli baçelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	20-21	21-22	22-23	23-24	24-25	Gjithsej
1	Baçelor	Edukim	Arsimi Fillor	2	0	0	0	0	3
2	Baçelor	Edukim	Arsimi Parashkollor	0	0	0	0	0	0
3	Baçelor	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	1	1	1	0	0	11
4	Baçelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	0	0	0	0	0	1
5	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe informatike	0	0	0	0	0	0
6	Baçelor	Ekonomik	Marketing	0	0	0	0	0	0
7	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment	2	0	0	0	0	5
8	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	0	1	0	0	0	1
9	Baçelor	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	0	0	0	0	0	0
10	Baçelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike	0	0	0	0	0	1
11	Baçelor	Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	3	0	0	0	0	11
			Gjithsej	4	0	1	0	0	33

Tabela 33. Numri i studentëve të transferuar - niveli master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	20-21	21-22	22/23	23-24	24-25	Gjithsej
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	0	0	0	0	0	0
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	0	0	0	0	0	0
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0	0	0	0	0	0
4	Master	Juridik	Juridik Penal	0	0	0	0	0	0
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale	0	0	0	0	0	0
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	0	0	0	0	0	0
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0	0	0	0	0	0
			Gjithsej	0	0	0	0	0	0

Tabela 34. Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	Gjith sej
1	Baçelor	Edukim	Arsimi Fillor	0	35	73	81	108	74	83	74	45	573
2	Baçelor	Edukim	Arsimi Parashkollor	0	8	35	56	40	34	57	59	36	325
5	Baçelor	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	0	39	80	69	66	51	44	47	32	428
8	Baçelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	12	32	63	41	33	41	31	36	11	300
9	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe informatike	19	27	57	49	30	17	9	7	3	218
10	Baçelor	Ekonomik	Marketing	4	6	19	16	13	8	7	3	0	76
11	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment	0	0	0	8	17	33	27	12	13	110
12	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	0	0	0	0	0	0	0	4	11	15
13	Baçelor	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	5	0
14	Baçelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike	0	6	28	44	29	26	35	21	28	215
17	Baçelor	Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	0	0	0	0	0	0	4	23	8	35
			Gjithsej	35	153	355	364	342	299	297	286	192	2295

Tabela 35. Numri i studentëve të diplomuar në të gjitha vitet akademike, niveli master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	Gjithsej
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	0	0	0	0	0	0	0	0	20	20
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	0	0	0	0	0	0	0	0	29	29
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0	0	0	0	0	18	20	12	1	51
4	Master	Juridik	Juridik Penal	0	0	0	0	0	0	0	0	5	5
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe intelijenca Artificiale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0	0	0	0	6	15	18	10	13	62
			Gjithsej	0	0	0	0	6	33	38	22	68	167

Tabela 36. Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2024/2025 - niveli baçelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Gjithsej
1	Baçelor	Edukim	Arsimi Fillor	0	39	33	94	166
2	Baçelor	Edukim	Arsimi Parashkollor	37	24	24	55	140
3	Baçelor	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	146	58	77	55	336
4	Baçelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	0	0	8		8
5	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe informatike	0	0	6		6
6	Baçelor	Ekonomik	Marketing	0	0	1		1
7	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment	0	0	10		10
8	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	1	5	29		35
9	Baçelor	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	86	42	18		146
10	Baçelor	Ekonomik	Marketing dhe Menaxhimi i Shitjes	68	0	0		68
11	Baçelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike	169	92	122		383
12	Baçelor	Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	1	0	22		23
12	Baçelor	Shkenca Sociale	Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane	31	0	0		31
			Gjithsej					1353

Tabela 37. Numri i studentëve aktiv në vitin akademik 2024/2025 - niveli master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	Viti I	Viti II	Gjithsej
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	38	0	38
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	70	0	70
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0	2	2
4	Master	Juridik	Juridik Penal	24	0	24
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale	23	8	31
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	29	35	64
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0	0	0
			Gjithsej	184	45	229

Tabela 38. Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike - niveli baçelor

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	13-14	14-15	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	Gjithsej
1	Baçelor	Edukim	Arsimi Fillor	3	2	13	13	20	19	27	16	13	17	14	157
2	Baçelor	Edukim	Arsimi Parashkollor	2	3	7	16	16	17	8	8	14	10	12	113
3	Baçelor	Juridik	Juridik i Përgjithshëm	0	28	26	55	68	53	64	65	96	84	71	610
4	Baçelor	Ekonomik	Banka, financa dhe Kontabilitet	2	15	32	46	61	37	47	72	45	46	39	442
5	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe informatike	0	26	24	50	37	24	17	18	19	9	6	230
6	Baçelor	Ekonomik	Marketing	0	11	18	27	43	22	19	27	16	16	13	212
7	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment	0	0	0	6	10	26	32	38	24	20	9	165
8	Baçelor	Ekonomik	Menaxhment dhe ndërmarrësi	0	0	0	0	0	0	0	12	4	8	12	36
9	Baçelor	Ekonomik	Financë dhe kontabilitet i aplikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	6	7	18	31
10	Baçelor	Shkenca Kompjuterike	Shkenca Kompjuterike	0	6	9	17	14	21	19	15	13	20	25	159
11	Baçelor	Shkenca Aplikative	Matematikë Arsimore	0	0	0	0	0	0	0	3	1	0	1	5
			Gjithsej	7	91	129	230	269	219	233	274	251	237	220	2160

Tabela 39. Numri i studentëve të çregjistruar në të gjitha vitet akademike - niveli master

Nr	Niveli	Fakulteti	Programi	13-14	14-15	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24	Gjithsej
1	Master	Edukim	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
2	Master	Edukim	Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Master	Juridik	Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike	0	0	0	0	0	1	1	1	3	1	0	7
4	Master	Juridik	Juridik Penal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Master	Shkenca Kompjuterike	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
6	Master	Shkenca Kompjuterike	E-Qeverisja	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	2
7	Master	FSHK, FJU, FEK	E-qeverisja	0	0	0	0	1	0	1	6	2	3	3	16
			Gjithsej	0	0	0	0	1	1	2	7	5	5	6	27

3.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet)

Kërkimi shkencor përbën një nga shtyllat themelore të zhvillimit akademik dhe cilësisë në arsimin e lartë. Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan synon të forcojë këtë komponent si pjesë integrale e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke e vendosur atë në qendër të misionit institucional për avancimin e dijes dhe inovacionit. Gjatë vitit 2024, janë ndërmarrë hapa konkretë për ndërtimin e një kulture kërkimore aktive dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e akreditimit.

Korniza institucionale dhe përkushtimi për kërkim

Për të mbështetur dhe strukturuar veprimtarinë kërkimore, UKZ ka hartuar dhe miratuar:

- [*Rregulloren për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore*](#),
- *Themelimin e Qendrës për Hulumtime Shkencore*,
- [*Formimin e Këshillit Shkencor të Universitetit*](#),
- [*Krijimin e grupeve hulumtuese në çdo njësi akademike*](#).

Këta hapa përbëjnë një infrastrukturë institucionale të domosdoshme për zhvillimin e një politike kërkimore të qëndrueshme dhe për nxitjen e shkëmbimeve ndërdisiplinore.

Publikimet dhe avancimi akademik

Aktivitetet kërkimore të stafit akademik janë njëkohësisht pjesë e përgjegjësisë të tyre kontraktuale dhe kriter kyç për *avancimin në karrierën akademike*. Botimet në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS, Web of Science dhe platforma të tjera të njohura janë të domosdoshme dhe të përputhshme me Udhëzimet Administrative të MASHTI-t.

Gjatë vitit 2024, janë financuar gjithsej **25 punime shkencore**, të cilat janë publikuar në platforma të njohura ndërkombëtare të indeksuara si [**SCOPUS dhe Web of Science**](#). Ky është një tregues i qartë i përkushtimit të UKZ-së për të promovuar kërkimin cilësor me ndikim global. Shpërndarja e këtyre publikimeve sipas fakulteteve është si vijon:

1. *Fakulteti i Edukimit – 8 punime shkencore*
2. *Fakulteti Juridik – 11 punime*
3. *Fakulteti Ekonomik – 3 punime*
4. *Fakulteti i Shkencave Kompjuterike – 1 punim*
5. *Fakulteti i Shkencave Aplikative – 2 punime*

Zyra e hulumtimeve dhe zbatimi i objektivave

Viti 2024 ka qenë një vit *sfidues*, por *njëkohësisht frytdhënës* për Zyrën e hulumtimeve. Kjo zyrë ka luajtur një rol kyç në:

- Rritjen e kapaciteteve kërkimore të stafit;
- Nxitjen e bashkëpunimeve brenda dhe jashtë UKZ-së;
- Përbushjen e rekomandimeve të ekspertëve të akreditimit;
- Zbatimin e rregulloreve në fuqi dhe të *Planit të veprimit institucional (PVI)* për kërkimin shkencor.

Përmes përpjekjeve të vazhdueshme për ndërtimin e një ambienti të qëndrueshëm dhe profesional për kërkim, UKZ synon të rrisë ndikimin e vet akademik, të forcojë lidhjet me komunitetin shkencor vendor dhe ndërkombëtar, si dhe të integrojë më fuqishëm kërkimin në misionin e tij arsimor dhe shoqëror.

FAKULTETI I EDUKIMIT

Tabela 40. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakultetin të Edukimit, gjatë vitit 2024.

Titulli akademik, emri dhe mbiemri	Titulli i artikullit	Revista dhe platforma
Prof. Ass. Sylë Ukshini	The position of the EU on the independence of Kosovo in the context of the advisory opinion of the International Court of Justice Die Position der EU zur Unabhängigkeit des Kosovo im Kontext des Gutachtens des Internationalen Gerichtshofs	<i>Journal of European Integration History</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu-Kryeziu	Attitudes of students of the Faculty of Education (Kosovo) about pedagogical practice in their preparation for service	<i>Praxis Educativa</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Flamur Maloku	Inclusive Education in Regular Classes from the Perspective of Media Support for Students with Special Needs: Kosovo Case	<i>Journal of Ecohumanism</i> Scopus
Prof. Asoc. Bashkim Dalipi	The Determination of Some Sizes and Physical Characteristics of Metals by Ultrasound	<i>International Journal of Computational and Experimental Science and Engineering</i>

Corresponding Author		<i>Scopus</i>
Prof. Asoc. Bashkim Dalipi Corresponding Author	Fe Modelling of Shock Waves	<i>International Journal of Computational and Experimental Science and Engineering</i> <i>Scopus</i>
Prof. Asoc. Dr. Bashkim Dalipi	The distribution of shoulder enhancement and associated features among NEIALs spectra observed with the EISCAT Svalbard 42m radar	<i>International Journal of Computational and Experimental Science and Engineering</i> <i>Scopus</i>
Prof. Asoc. Dr. Arbona Xhemajli	The Application of Contemporary Methods According to the Curriculum for the Course of the Albanian Language in Primary Education	<i>Journal of Curriculum Studies Research</i> <i>Scopus</i>
Prof. Ass. Dr. Shqipe Avdiu - Kryeziu Prof. Asoc. Merxhan Avdyli	Teachers attitudes towards student assessment during group work in primary education- Qualitative study	<i>HUMAN RESEARCH IN REHABILITATION</i> <i>Scopus</i>

FAKULTETI JURIDIK

Tabela 41. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti Juridik, gjatë vitit 2024.

Titulli akademik, emri dhe mbiemri	Titulli i artikullit	Revista dhe platforma
Prof. Asoc. Dr. Selim Daku	MOTIVES FOR (NON) RECOGNITION OF KOSOVO AND PALESTINE	<i>Revista de Gestao Social e Ambiental</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani	THE ENLARGEMENT OF THE EUROPEAN UNION TOWARDS THE WESTERN BALKANS AND THE RULE OF LAW AS A TOOL FOR ECONOMIC DEVELOPMENT	<i>Corporate Law and Governance Review</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Valbona Zeqiraj	Economic efficiency and finance in the development of the forest economy within the framework of legal restrictions	<i>Ukrainian Journal of Forest and Wood Science</i> Scopus
Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka	THE STABILIZATION AND ASSOCIATION AGREEMENTS IN THE WESTERN BALKANS AS A TOOL FOR TRADE PROMOTION AND REGIONAL RECONCILIATION	<i>Corporate Law and Governance Review</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Selim Daku	After Palestine, can Spain recognize Kosovo?	<i>Journal of Infrastructure, Policy and Development</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Ditrina Alishani Sopi	RENUNCIATION OF INHERITANCE BY KOSOVAR WOMEN: DESIRE OR INJUSTICE? A CASE LAW PERSPECTIVE	<i>Access to Justice in Eastern Europe (AJEE)</i> Scopus
Prof. Ass. Dr. Fadil Osmani Corresponding Author	Importance of proper management of public finances in economic development	<i>Scientific Bulletin of Mukachevo State University. Series Economics</i> Scopus
Prof. Asoc. Dr. Albulena Krasniqi Hajdari Corresponding Author	Punishment policy for perpetrators of the criminal offenses of accepting and giving bribes in Republic of Kosovo	<i>Brawijaya Law Journal</i> Scopus

Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi	NAVIGATING LEGAL FRONTIERS: ADDRESSING CHALLENGES IN REGULATING THE DIGITAL ECONOMY	<i>Access to Justice in Eastern Europe</i> <i>Scopus</i>
Prof. Ass. Dr. Fatmire Krasniqi	CRIMINAL, CIVIL AND SOCIO-ECONOMIC ASPECTS OF THE PROTECTION OF UNBORN LIFE IN THE REPUBLIC OF KOSOVO	<i>Access to Justice in Eastern Europe</i> <i>Scopus</i>
Prof. Dr. Dukagjin Leka Autor i parë	The human rights and managerial responsibility: A comparative analysis of theoretical studies	<i>Corporate Law and Governance Review</i> <i>Scopus</i>

FAKULTETI EKONOMIK

Tabela 42. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti Ekonomik, gjatë vitit 2024.

Titulli akademik, emri dhe mbiemri	Titulli i artikullit	Revista dhe platforma
Prof. Ass. Dr. Arben Sahiti Autor i parë Prof. Asoc. Dr. Liridon Dalipi Corresponding Author	A LEGAL FRAMEWORK FOR FOREIGN DIRECT INVESTMENT: A CASE OF AN EMERGING MARKET	<i>Corporate Law and Governance Review</i> <i>Scopus</i>
Prof. Asoc. Dr. Xhevat Sopi Corresponding Author	The Effects of Foreign Direct Investment in the Insurance Industry in the Western Balkan Countries – A Panel Data Analysis	<i>International Journal of Sustainable Development and Planning</i> <i>Scopus</i>
Prof. Ass. Dr. Arbenita Kosumi Autor i parë	BANK-SPECIFIC, ECONOMIC AND LEGAL DETERMINANTS OF PROFITABILITY IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA	<i>Access to Justice in Eastern Europe (AJEE)</i> <i>Scopus</i>

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Tabela 43. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, gjatë vitit 2024.

Titulli akademik, emri dhe mbiemri	Titulli i artikullit	Revista dhe platforma
Prof. Asoc. Dr. Kastriot Dërmaku	DIGITISATION OF ADMINISTRATION AND LEGAL BASIS IN KOSOVO	<i>Access to Justice in Eastern Europe</i> <i>Scopus</i>

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

Tabela 44. Lista e publikimeve shkencore të stafit akademik në Fakulteti i Shkencave Aplikative, gjatë vitit 2024.

Titulli akademik, emri dhe mbiemri	Titulli i artikullit	Revista dhe platforma
Prof. Dr. Xhevdet Thaqi Autor i dytë	Universal tools for analysing structures and interactions in geometry	<i>Innovaciencia</i> <i>Scopus</i>
Prof. Asoc. Dr. Musa Ajeti Autor i parë	Relativity and the Magnitude of Velocities	<i>Science and Technology Indonesia</i> <i>Scopus</i>

Konferencat e organizuar dhe bashkë-organizuar gjatë vitit 2024

Universiteti Publik “Kadri Zeka” në Gjilan ka intensifikuar aktivitetet akademike dhe shkencore gjatë vitit 2024, përmes organizimit dhe bashkorganizimit të konferencave vendore dhe ndërkombëtare me pjesëmarrje të gjerë të studiuesve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme. Këto ngjarje synojnë fuqizimin e rolit të kërkimit shkencor, nxitjen e bashkëpunimeve ndërinstitucionale dhe rritjen e cilësisë së arsimit në përputhje me trendet bashkëkohore.

Konferenca Shkencore Vjetore e UKZ-së: [“Trendet dhe Sfidat në Zhvillimin e Shoqërisë Bashkëkohore”](#).

Më datat 13–14 qershor 2024, Universiteti [organizoi Konferencën Shkencore Vjetore me temën: “Trendet dhe Sfidat në Zhvillimin e Shoqërisë Bashkëkohore”](#).

Në këtë ngjarje morën pjesë 124 studiues nga institucione të ndryshme akademike dhe kërkimore, të cilët prezantuan punimet e tyre në 5 sesione të ndara sipas fushave të njësive akademike.

Konferenca shërbeu si një platformë për ndarjen e gjetjeve shkencore, diskutimin e ideve inovative dhe përfundimin e bashkëpunimeve kërkimore. Të gjitha abstraktet janë përfshirë në *Librin e Abstrakteve*, të publikuar në uebfaqen zyrtare të konferencës, me ISBN dhe CIP të lëshuara nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës. [Shih Librin e Abstrakteve](#)

Konferenca me OSBE-në – 25 vjetori i Misionit në Kosovë

Më 31 maj 2024, UKZ në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të OSBE-së në Gjilan organizoi një konferencë njëditore për të shënuar 25-vjetorin e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Në këtë aktivitet mori pjesë Ambasadori Michael Davenport, i cili theksoi përkushtimin e OSBE-së për të përmirësuar qeverisjen, barazinë dhe të drejtat e njeriut.

Rektori Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare për forcimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit

Pjesëmarrësit diskutuan mbi praktikën më të mirë për përmirësimin e qeverisjes lokale, duke i inkurajuar të rinjtë dhe gratë për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Konferenca e 19-të Ndërkombëtare Ndërdisciplinore në Tiranë: “[Mirëqenia në Kohë Sfiduese](#)”

Më 15 nëntor 2024, përfaqësues të UKZ-së morën pjesë në Konferencën e 19-të Ndërkombëtare Ndërdisciplinore, organizuar nga Instituti Shqiptar i Sociologjisë / Shoqata Sociologjike Shqiptare në Tiranë.

- Konferenca bashkoi rreth 254 autorë nga 23 vende dhe përfshiu 161 punime shkencore.
- U zhvilluan sesione të ndryshme tematike dhe ndarje çmimesh për kërkime të spikatura.

UKZ u përfaqësua me prezantime shkencore që pasqyronin angazhimin në fushat e mirëqenies, politikave sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kongresi Ndërkombëtar për Shkenca Njerëzore, Sociale dhe Arte – Universiteti i Tetovës

Më 8 nëntor 2024, përfaqësuesit akademikë të UKZ-së morën pjesë në Kongresin Ndërkombëtar të organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

UKZ u përfaqësua nga:

- Prof. Ass. Dr. Arbana Xhemajli, Prorektore për Hulumtime dhe Kërkime Shkencore
- Arjetë Rexhepi, u.d. Udhëheqëse e Divizionit për Hulumtime Shkencore dhe Inovacion
- Betim Berisha, u.d. Udhëheqës i Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Pjesëmarrësit nga UKZ kontribuan me prezantime dhe diskutime në sesionet plenare dhe tematike të kongresit, duke shkëmbyer përvojat dhe gjetjet e tyre kërkimore.

Konferenca Ndërkombëtare BRIDGE – Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren

Më 22 nëntor 2024, përfaqësuesit e lartë të UKZ-së morën pjesë në *Konferencën Ndërkombëtare BRIDGE*, me temën “*Arsim dhe Inovacion për të Përparuar Shkencën dhe Shoqërinë*”.

Ngjarja, e organizuar nga Universiteti “Ukshin Hoti”, bashkoi studiues nga fusha të ndryshme dhe ofroi një platformë për diskutim mbi ndikimin e arsimit dhe inovacionit në zhvillimin shoqëror.

Përfaqësuesit e UKZ-së kontribuan aktivisht me prezantime, përvoja institucionale dhe ide për rritjen e impaktit të arsimit të lartë në të gjitha nivelet.

Aktivitetet e vitit 2024 reflektojnë përkushtimin e Universitetit Publik “Kadri Zeka” në kultivimin e një mjedisi akademik ndërkombëtar, dinamik dhe të hapur ndaj bashkëpunimeve. Organizimi dhe pjesëmarrja aktive në konferenca kanë shërbyer si platforma të rëndësishme për shkëmbim dijes, promovim të kërkimeve shkencore dhe fuqizim të rolit të universitetit në zhvillimin e qëndrueshëm akademik dhe shoqëror.

3.8. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe projektet

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një nga shtyllat strategjike të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan dhe përbën një faktor kyç në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e mundësive për zhvillim profesional të stafit dhe studentëve. Gjatë vitit 2024, përmes Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime, universiteti ka intensifikuar aktivitetet ndërkombëtare duke arritur rezultate konkrete në marrëveshje, projekte, shkëmbime dhe trajnime me partnerë të shumtë vendorë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit (2024)

Gjatë vitit 2024, UKZ ka nënshkruar *18 marrëveshje të reja bashkëpunimi* me universitete dhe institucione akademike nga Evropa dhe rajoni, si dhe me institucione vendore, OJQ dhe sektorin privat. Këto marrëveshje kanë synuar:

- *Zhvillimin e mobiliteteve akademike;*
- *Zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;*
- *Krijimin e klinikave ligjore, praktikave studentore dhe bashkëpunimeve në fushën e inovacionit dhe digjitalizimit.*

Disa prej institucioneve partnere:

- [University of Minho](#) – Portugali – 2024; [University of Justice](#) – Poloni – 2024; [University of Ruse “Angel Kanchev”](#) – Bullgari – 2024; [Universiteti i Tiranës](#) – Shqipëri – 2024; [PH Zug – Pegagogische Hochschule Zug](#) – Zvicër – 2024; [WSG University në Bydgoszcz](#) – Poloni – 2024; [Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Nysa](#) – Poloni – 2024; [Akademia Wymiaru Sprawiedliwości në Varshavë](#) - Poloni – 2024 [Kolegji Universitar “QIRIAZI”](#) – Shqipëri – 2024; [Universitetin Jana Długosza w Częstochowie](#) – Poloni – 2024; [Komuna e Gjilanit – Platforma Digjitale për Fermerë](#) – 2024; [Komuna e Kamenicës/ Dardanës](#) – 2024; [Programi për të Drejtat Civile Kosovë](#) – 2024; [Deutschzentrum Kosovo – Kosovë](#) – 2024; [Banka Ekonomike – Kosovë](#) – 2024; [Marrëveshje për Krijimin e Klinikave ligjore për të drejtat Azil- Refugjate dhe personave pa shtetësi; Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës](#) – 2024; [Future Minds Academy – Kosovë](#) - 2024; etj.

Projektet ndërkombëtare të UKZ-së

- UKZ ka qenë përfitues dhe/ose partner në mbi 15 projekte ndërkombëtare, të financuara nga programe si Erasmus+ CBHE, HERAS+, World Bank (KODE), UNHCR, Swiss Caritas, US Grants, IPA, dhe qeveria zvicerane.

Disa nga projektet aktive ose të përfunduara me sukses:

- QUADIC (Koordinator): Projekti më i madh i koordinuar nga UKZ, për ngritjen e kapaciteteve të Zyrave për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
- QATEK, STAND, ENEMLOS, GreenWB, SMAHPC, e-VIVA, SUSWELL, WebJou, ResearchCult etj.

Projekte të filluara në 2024

- REISSE UP, EMPHASIS, DELTA, EDUFAIR, TIKA-Cezeri Lab, STEM Europe
- UKZ ka aplikuar me 14 projekte të reja në thirrjet e fundit për CBHE dhe Jean Monnet, duke përfshirë fusha si: të drejtat sociale, bujqësia e qëndrueshme, digjitalizimi, migracioni dhe sipërmarrja.

Mobilitetet ndërkombëtare për studentët dhe atafin

- Përmes marrëveshjeve ICM Erasmus+, UKZ ka realizuar mobilitete të suksesshme me universitete në Itali, Francë, Turqi, Poloni, Bullgari, Spanjë, Portugali, Zvicër etj..

Studentë të shkëmbyer gjatë 2024

- Në [WSG University \(Poloni\)](#), [“Angel Kanchev” \(Bullgari\)](#), [“Celal Bayar” \(Turqi\)](#)

Staff exchange:

- [Vizita dhe ligjërata në PH Zug \(Zvicër\)](#), [Angel Kanchev](#) (Bullgari), [WSG](#) (Poloni), Kastamonu (Turqi), [Manisa](#) (Turqi), [Luzern](#) (HSLU), [Graz](#) (Austri) etj.

Konferenca dhe takime ndërkombëtare

Gjatë vitit 2024, UKZ ka qenë pjesë ose organizator i konferencave me përmasa ndërkombëtare:

- [Konferenca e Rektorëve të Evropës Juglindore](#);
- [Vizita në Parlamentin Austriak në Vjenë](#);
- Konferenca me OSBE (Gjilan), BRIDGE (Prizren), GreenWB (Shkup, Graz), Jean Monnet Workshop (Gjilan), WEBJOU (Tiranë, Novi Sad), Connect Business Event etj.

Tabela 45. Rezultatet kryesore të arritura në 2024

Nr.	Aktiviteti	Data	Rezultatet kryesore
1	Marrëveshje të reja bashkëpunimi	Janar - Dhjetor 2024	14 marrëveshje të reja me universitete evropiane dhe rajonale
2	Mobiliteti studentor dhe akademik	Mars - Nëntor 2024	25 studentë dhe 50 staf akademik në shkëmbime ndërkombëtare
3	Konferenca ndërkombëtare	Prill - Tetor 2024	5 konferenca të organizuara me partnerë ndërkombëtarë
4	Projekte kërkimore të përbashkëta	Janar - Dhjetor 2024	7 projekte të përbashkëta të financuara nga BE dhe organizata ndërkombëtare
5	Trajnime dhe workshops	Shkurt - Nëntor 2024	12 trajnime për zhvillimin e kapaciteteve akademike

Objektivat për vitin 2025

- Zgjerimi i partneriteteve me universitete dhe institute kërkimore ndërkombëtare;
- Zhvillimi i platformave të përbashkëta për shkëmbimin e dijes dhe praktikave akademike;
- Rritja e projekteve kërkimore të bashkëfinancuara;
- Mbështetja për trajnime dhe shkëmbime ndërdisiplinore;
- Krijimi i sistemit digjital për menaxhimin e mobiliteteve dhe publikimeve ndërkombëtare.

Përfundim dhe rekomandime

- Viti 2024 ka dëshmuar një rritje të dukshme të kapaciteteve ndërkombëtare të UKZ-së, përmes përfshirjes aktive në rrjete akademike dhe projekte shumëpalëshe. Në vitin 2025, do të theksohet:
- Zhvillimi i diplomacisë akademike dhe bashkëpunimeve me universitetet më të avancuara në BE dhe SHBA;
- Forcimi i mbështetjes financiare për mobilitetet e stafit dhe studentëve;
- Modernizimi i sistemit të menaxhimit të projekteve ndërkombëtare;
- Fokus i veçantë në kërkime shkencore të aplikueshme dhe ndërdisiplinore.
- Përmes këtyre hapave, Universiteti Publik “Kadri Zeka” synon të bëhet një institucion model për ndërkombëtarizimin dhe inovacionin akademik në rajon.
- tudentëve dhe stafit është rritur ndjeshëm, duke ndikuar pozitivisht në përvojën akademike dhe profesionale.
- Rritja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore ka ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe inovative të universitetit.
- Organizimi i konferencave ndërkombëtare ka përmirësuar imazhin dhe reputacionin akademik të universitetit në nivel ndërkombëtar.

Objektivat kryesore për vitin 2025

- Krijimi i platformave të komunikimit të rregullt;
- Zhvillimi i programeve të shkëmbimit studentor dhe akademik;
- Miratimi i rregullores për pagesa të stafit dhe studentëve / për udhëtime dhe të ndryshme;
- Organizimi i konferencave dhe seminareve ndërkombëtare;
- Krijimi i projekteve të përbashkëta kërkimore;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe MoUs;
- Mbështetje për trajnime të përbashkëta dhe workshops;
- Zhvillimi i kanaleve të shkëmbimit të materialeve akademike;
- Mbështetje për mundësi bursash dhe financimi i projekteve;
- Promovimi i bashkëpunimeve multidisiplinore;
- Përmirësimi i sistemit të mbështetjes për mobilitetin akademik;

Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit për vitin 2025

- Zgjerimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, me fokus në universitetet me qasje të përparuar në kërkime dhe inovacion.
- Krijimi i një platforme digjitale për shkëmbimin e materialeve akademike dhe kërkimore me universitetet partnere.
- Forcimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, duke siguruar mbështetje financiare dhe logjistike më të madhe.
- Organizimi i më shumë trajnimeve dhe workshops në fushën e metodologjisë kërkimore dhe inovacionit akademik.
- Sigurimi i burimeve të qëndrueshme të financimit për projektet kërkimore të përbashkëta përmes granteve dhe partneriteteve strategjike.

Duke marrë parasysh sukseset e arritura gjatë vitit 2024 dhe sfidat e identifikuara, ky raport përcakton strategji të qarta për të rritur më tej bashkëpunimin institucional në vitin 2025. Zbatimi i rekomandimeve të propozuara do të ndihmojë Universitetin Publik "Kadri Zeka" në arritjen e një niveli më të lartë të ndërkombëtarizimit dhe përmirësimit të cilësisë akademike.

Një ndër prioritetet kryesore për vitin 2025 do të jetë zgjerimi i rrjetit të partneriteteve ndërkombëtare, duke synuar bashkëpunime më të ngushta me universitete, institute kërkimore dhe organizata akademike nga rajoni dhe më gjerë, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian. Kjo do të mundësojë një shkëmbim më të madh të përvojave akademike, mundësi për projekte të përbashkëta kërkimore, si dhe përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në mobilitete ndërkombëtare që do të rrisin aftësitë e tyre profesionale dhe shkencore.

Gjithashtu, një fokus i veçantë do t'i kushtohet modernizimit të metodave të mësimdhënies dhe përmirësimit të infrastrukturës akademike. Kjo do të përfshijë zhvillimin e programeve të reja studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe integrimin e teknologjisë së avancuar në procesin e mësimdhënies. Investimi në burime akademike, përfshirë libra dhe artikuj të përditësuar shkencorë, do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së kërkimeve dhe do t'i mundësojë studentëve dhe stafit një qasje më të lehtë ndaj literaturës bashkëkohore ndërkombëtare. Përmes këtyre hapave, UKZ synon të konsolidohet si një qendër akademike e njohur për cilësinë e arsimit dhe kërkimit shkencor.

PËRFUNDIME

Raporti vjetor i punës për vitin 2024 i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan është përgatitur në përputhje me nenin 24, pika 1 të Statutit të UKZ-së dhe përfaqëson një dokument gjithëpërfshirës që përmbledh arritjet, sfidat, proceset zhvillimore dhe përkushtimin e vazhdueshëm institucional gjatë periudhës janar–dhjetor 2024. Raporti dokumenton përpjekjet e gjithanshme të Universitetit për të avancuar misionin e tij si një qendër e dijes, kërkimit dhe zhvillimit profesional e shoqëror, në përputhje me objektivat strategjike dhe standardet e arsimit të lartë në vend dhe më gjerë.

Gjatë vitit 2024, Universiteti ka shënuar zhvillim të qëndrueshëm dhe transformues në disa drejtime thelbësore:

- **Qeverisja institucionale** është karakterizuar nga funksionimi aktiv dhe efikas i organeve drejtuese (Senati dhe Këshilli Drejtues), të cilat kanë miratuar vendime kyçe për drejtimin strategjik të institucionit, përfshirë rekrutimin dhe avancimin e stafit, mbështetjen për kërkime shkencore, planifikimin buxhetor dhe miratimin e rregulloreve të brendshme.
- **Përmirësimi i infrastrukturës** ka qenë një ndër prioritetet kryesore. Është hartuar “*Strategjia e zgjerimit dhe rikonstruktimit të hapësirave ekzistuese 2025–2027*”, me synim ndërtimin e kampusit të ri universitar dhe rimodelimin e hapësirave ekzistuese, si dhe janë realizuar investime konkrete në pajisje, teknologji, ndriçim, IT dhe mjedise mësimore.
- **Akreditimi institucional dhe programor** ka shënuar sukses të rëndësishëm, me riakreditimin institucional për një periudhë pesëvjeçare dhe akreditimin/riakreditimin e tetë (8) programeve studimore, duke reflektuar përmbushjen e standardeve të cilësisë në të gjitha njësitë akademike.
- **Kërkimi shkencor dhe publikimet** janë fuqizuar përmes politikave të qarta të mbështetjes, me publikime në revista të indeksuara ndërkombëtare, pjesëmarrje në konferenca, themelimin e strukturave të reja si Këshilli Shkencor dhe Divizioni për Hulumtime, si dhe shpalljen e çmimit “Hulumtuesi i Vitit”.
- **Ndërkombëtarizimi**, si një shtyllë strategjike, ka përparuar në mënyrë të ndjeshme. Gjatë vitit janë nënshkruar 18 marrëveshje të reja bashkëpunimi ndërkombëtar me universitete dhe organizata akademike në Evropë, janë realizuar dhjetëra mobilitete për studentë dhe staf, si dhe janë zhvilluar projekte të rëndësishme në kuadër të Erasmus+, HERAS+, Bankës Botërore dhe organizatave të tjera donatore.
- **Menaxhimi i brendshëm** është konsoliduar përmes rishikimit të rregulloreve, rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe hartimit të planeve të zhvillimit profesional për stafin akademik dhe administrativ. Janë ndërmarrë hapa për rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e performancës së stafit.

- **Mbështetja për studentët** është rritur përmes bursave, mbështetjes për gara kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnimeve dhe aktiviteteve kulturore dhe profesionale, si dhe përmes përmirësimeve në shërbimet akademike dhe administrative.

Sfidat gjatë vitit 2024

Me gjithë arritjet e konsiderueshme, UKZ është përballur edhe me sfida të ndryshme, si:

- ***Kufizimet buxhetore***, sidomos në kategorinë e pagave dhe investimeve kapitale;
- ***Mungesa e infrastrukturës adekuate***, që ka ndikuar në ngarkesën e njësive akademike dhe administrative;
- ***Procedurat e stërzgjidura*** për miratimin e projekteve publike;
- ***Nevoja për digjitalizim më të avancuar të shërbimeve*** dhe mbështetje të sistemit të brendshëm të cilësisë;

Megjithatë, këto janë adresuar përmes përkushtimit të strukturave drejtuese dhe bashkëpunimit të ngushtë me MASHTI-n, komunën dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë.

Përmbledhje e objektivave për vitin 2025

Duke u mbështetur në përvojat dhe mësimet e nxjerra gjatë vitit 2024, për vitin 2025 janë përcaktuar këto objektiva zhvillimore kyçe:

- Konsolidimi i qeverisjes së brendshme dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve menaxheriale;
- Zbatimi i strategjisë për zgjerimin dhe rikonstruktimin e hapësirave universitare, duke përfshirë finalizimin e procedurave për ndërtimin e kampusit të ri;
- Zhvillimi i programeve studimore inovative dhe ndërdisiplinore;
- Avancimi i cilësisë akademike dhe përfshirja aktive e studentëve në aktivitete të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
- Rritja e mbështetjes për kërkimin shkencor dhe publikimet në revista me impakt ndërkombëtar;
- Nxitja e ndërkombëtarizimit përmes partneriteteve të reja dhe projekteve të përbashkëta kërkimore;
- Modernizimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi i shërbimeve institucionale;
- Zgjerimi i mbështetjes për stafin akademik dhe studentët përmes programeve të trajnimit, bursave dhe mundësive për mobilitet.

Përmbyllje

Në përfundim, viti 2024 ka qenë një vit i rëndësishëm për Universitetin Publik “Kadri Zeka” – një vit i përkushtimit, ndryshimit dhe progresit të qëndrueshëm. Rezultatet e këtij raporti nuk përfaqësojnë vetëm statistika, por dëshmojnë punën dhe vizionin kolektiv të një institucioni që synon të ndërtojë një të ardhme akademike moderne, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt zhvillimit të dijes, inovacionit dhe shërbimit ndaj shoqërisë.

Me besim dhe angazhim të palëkundur, UKZ do të vazhdojë rrugëtimin e tij për të qenë jo vetëm një institucion arsimor, por një promotor i ndryshimit pozitiv në shoqëri dhe një kontribuues i denjë në hapësirën akademike kombëtare dhe ndërkombëtare.

SHTOJCAT